



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry Of Environment, Spatial Planning and Infrastructure



ARPL

AUTORITETI I RAJONIT TË PELLGJEVE LUMORE

RAPORTI I VËRSHIME NË KOSOVË



DIVIZIONI PËR
PLANIFIKIM
TË RESURSEVE
UJORE

Prishtinë, Janar 2023

Titulli:	"RAPORTI I VËRSHIMEVE NË KOSOVË"
Institucioni:	"Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës" Rilindja, kati i 16-të - 10000 Prishtinë (Kosovë)
Referenca nr.:	19-20/2023/ARPL
Data e fillimit:	19 Shkurt 2023
Data e përfundimit:	13 Shtator 2023
Autoriteti Kontraktues:	Autoriteti Rajonit të Pellgjeve Lumore (ARPL) Z. Naser AFIZI , ud Udhëheqës i ARPL-së Rilindja, kati i 16-të - 10000 Prishtinë (Kosovë) Tel .: + 383- (0) 38-20032235; Faksi: + 383- (0) 38-517558 Emali: Naser.Afizi@rks-gov.net
Divizioni:	Divizioni për Planifikimin e Resurseve Ujore (DPRU) Znj. Fatlije BUZA , Udhëheqëse e DPRU-së Rilindja, kati i 16-të - 10000 Prishtinë (Kosovë) Tel .: + 383- (0) 38-20032235; Faksi: + 383- (0) 38-517558 Emali: Fatlije.Buza@rks-gov.net
Autor të Raportit:	Sylejmon LATIFI , ing.dipl.gjeolog Zyrtar për Ndryshime Klimatike, Vërshime dhe Thatësira Rilindja, kati i 16-të - 10000 Prishtinë (Kosovë) Tel .: + 383- (0) 38-20032235; Faksi: + 383- (0) 38-517558 Emali: Sylejmon.Latifi@rks-gov.net Sebastina VOKRRI , Profesioniste e Re për Vlerësimin e Sedimenteve dhe Rrezikut ndaj Vërshimeve Rilindja, kati i 16-të - 10000 Prishtinë (Kosovë) Tel .: + 383- (0) 38-20032235; Faksi: + 383- (0) 38-517558 Emali: sebastina.vokri@int.skat.ch
Kontrolli i cilësisë:	Msc. Fidan BILALLI , Hidrogjeolog Zyrtar i Lartë i Sistemit Informativ Ujor Rilindja, kati i 16-të - 10000 Prishtinë (Kosovë) Tel .: + 383- (0) 38-20032235; Faksi: + 383- (0) 38-517558 Emali: Fidan.Bilalli@rks-gov.net

PËRMBAJTJE

1. HYRJE.....	1
1.1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1
1.2. PËRMBLEDHJE KRYESORE	1
2. INSTITUTI HIDROMETEOROLOGJIK I KOSOVËS	3
2.1. Paralajmrimi për vërshime.....	3
3. MINISTERIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS.....	8
3.1. Komunikata	8
3.2. Vizita e Ministrit Z. Liburn Aliu në Komunën e Skenderajit dhe Mitrovicës.....	8
3.3. Vizita e Zv.Ministres Znj. Linda Qavdërbasha në Komunën e Klinës, Istogut dhe Pejës	9
3.4. Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore	10
3.5. Vizitë në Komunën e Skenderajit me ekspertët ndërkombëtar të projektit “Hartat e Rrezikut dhe Rrezikshmërisë nga Vërshimet në Kosovë”	13
4. MINISTERIA E PUNËVE TË BRENDSHME - AGJENCIA E MENAXHIMIT EMERGJENT	17
4.1. Ministria e Punëve të Brendshme.....	17
4.2. Ministri Z. Sveçla takoi Koordinatorin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Kosovë Znj. Arnhild Spence	17
4.3. Veprimet Operacionale me Rastin e Vërshimeve	18
4.3.1. Raportet për Situatat e Vërshimeve	18
5. MINISTERIA E MBROJTJES E REPUBLIKËS SË KOSOVËS	23
5.1. Ministri Z. Mehaj – vizitë në Komunën e Mitrovicës	23
5.2. Kryeministri Z. Kurti, Ministri Z. Mehaj, Ministri Z. Krasniqi – vizitë në Komunën e Klinës dhe Istogut	24
5.3. Ministri i Mbrojtjes Z. Mehaj me Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal Z. Krasniqi – vizitë në Komunën e Skenderajit.....	25
5.4. Forca e Sigurisë së Kosovës.....	25
6. ZYRA E KRYEMINISTRIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS.....	27
6.1. Vizita e Kryeministrit të Republikës së Kosovës në Komunën e Skenderajit	27
6.2. Komisioni Qëbdror për Vlerësimin e Dëmeve.....	28
7 MINISTERIA E ARSIMIT, SKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT	29
8 MINISTERIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL.....	30
9 INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETIT PUBLIK I KOSOVËS	33
9.1. Rekomandimet Për Mbrojtjen E Shendetit IKSHP/QRSHP	33
10 PELLGJET LUMORE DHE KOMUNAT.....	47
10.1. Pellgu lumor Ibër-Sitnica.....	47
10.1.1. Komuna e Mitrovicës 19.01.2023	47
10.1.2. Komuna e Drenasit.....	52
10.1.3. Komuna e Podujevës 19.01.2023.....	53
10.1.4. Komuna e Mitrovicës së Veriut 19.01.2023	57
10.1.5. Komuna e Leposaviqit 19.01.2023	59
10.1.6. Komuna e Zveçanit.....	61
10.1.7. Komuna e Zubin Potokut.....	63
10.2. Pellgu lumor Drini i Bardhë	64
10.2.1. Komuna e Skenderajit	64
10.2.2. Komuna e Klinës.....	70
10.2.3. Komuna e Istogut	75
10.2.4. Komuna e Deçanit	79
11 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	81
11.1. Konkluzione.....	81
11.2. Rekomandime	81
BIBLIOGRAFIA	82

Shkurtesat:

ARPL	Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore
AME	Agjencioni i Menaxhimit Emergjent
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjetës
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
ZKM	Zyra e Kryeministrit të Kosovës
SHA	Shoqëri Aksionare
UA	Udhëzim Administrativ
DUMA	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit
DSHP	Drejtoria e Shërbimeve Publike
SHMS	Shëndeti dhe Mirëqenia Sociale
NTU	Standardi i Cilësisë së Turbullirës në Ujë
DZSH	Departamenti i Zjarrfikjes dhe Shpëtimit
QOE	Qendra Operative Emergjente
QRShP	Qendra Rajonale e Shëndetit Publik
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
ZRRPDV	Zonat me Rrezik Potencial Domethënës të Vërshimeve

Lista e figurave

Figura 1. Zonat me Rrezik Potencial Domethënës të Vërshimeve	2
Figura 2. Zonat e ekspozuara me rrezik potencial të vërshimeve në Kosovë	2
Figura 3. Situata Meteorologjike gjatë ditëve në vijim	6
Figura 4. Probabiliteti që parashikimet e përmbytjeve të tejkalojnë pragun e periudhës së kthimit 5 – vjeçar të EFAS. Gama e parashikimit 0-48 orë.....	7

Lista e tabelave

Tabela 1. Sasit e reshjeve nëpër disa Stacione Meteorologjike Automatike në Kosovë.....	4
Tabela 2. Njoftimi i IHMK-së me datë 19/01/2023	5

Lista e fotografive

Fotografia 1. Pastrimi i rrugës në fshatin Zubq	8
Fotografia 2. Takim me qytetarët e Komunës së Skenderajit	9
Fotografia 3. Takim me banorët e prekur nga vërshimet në K. Klinë.....	9
Fotografia 4. Fshati Osojan 20.01.2023	10
Fotografia 5. Fshati Kernin 20 .01.2023	10
Fotografia 6. Në komunën e Pejës dhe në fshatin Radofc 20.01.202	10
Fotografia 7. Fshati Lisicë, K. Mitrovicë (19.01.2023).....	11
Fotografia 8. Qyteti i Mitrovicë (19.01.2023).....	11
Fotografia 9. Lumi Lushta (Mitrovicë, 19.01.2023)	11
Fotografia 10. Fshati Llaush (Skenderaj, 19.01.2023)	12
Fotografia 11. Sheshi Ilaz Kodra Skenderaj (19.01.2023).....	12
Fotografia 12. Takimi me kryetarin dhe nënkryetarin e komunës së Skenderajit, z. Nura dhe z. Lushtaku ...	13
Fotografia 13. Takimi me zyrtarin e emergjencave z. Sokol Hoxha.....	14
Fotografia 14. Takimi me drejtorët e departamenteve dhe përfaqësues të ndryshëm të Komunës	14
Fotografia 15. Fotografi nga droni të shtratit të lumit Klina dhe daljes së tij nga shtrati	15
Fotografia 16. Fotografi nga droni të dëmeve të shkaktuara nga dalja e shtratit të lumit Klina	15
Fotografia 17. Vëzhgim me dron të dëmeve të shkaktuara në qendrën e qytetit dhe foto e ekipës së terrenit	16
Fotografia 18. Takim nga zyra e Ministrit Z. Sveçla	17
Fotografia 19. Gjatë intervenimit në terren	22
Fotografia 20. Reagimi i FSK në Komunën e Mitrovicës.....	23
Fotografia 20. Takimi në terren i Ministrit Z. Mehaj me Kryetarin e K.Mitrovicës Z. Hamza.....	23
Fotografia 22. Kryeministri me Ministrin e Mbrojtjes në Komunën e Istogut	24
Fotografia 23. Takim me stafin e QKMF	24
Fotografia 24. Vizita në Skenderaj e Ministrit të Mbrojtjes	25
Fotografia 25. FSK gjatë reagimit	26
Fotografia 26. Tërheqja e banorve nga zona vërshuese	26
Fotografia 27. Vizita e Kryeministrit në Skenderaj	27
Fotografia 28. Vizita e Kryeministrit Mitrovicë ..	27
Fotografia 29. Vizita e Kryeministrit në terren në Komunën e Skenderajit	27
Fotografia 29. Vizita e Kryeministrit në terren në Komunën e Mitrovicës.....	28
Fotografia 31. Vizita në Klinë.....	30
Fotografia 32. Vizita në Klinë.....	30
Fotografia 33. Vizita në Klinë.....	31

Fotografia 34. Vizita në Klinë.....	31
Fotografia 35. Vizita në Skenderaj.....	32
Fotografia 36. Vizita në Istog.....	32
Fotografia 37. Vizita në Istog.....	32
Fotografia 38. Uji i pijshëm.....	33
Fotografia 39. Uji i pijes.....	40
Fotografia 40. Takim në Komunën e Mitrovicës dhe në terren.....	47
Fotografia 41. Kryetari i Komunës së Mitrovicës në takim me AME.....	48
Fotografia 42. Takim i të gjitha strukturave kumunale.....	48
Fotografia 43. Shpërndarja e ndihmave për banorët e zonave të vërshuara.....	49
Fotografia 44. Mobilizimi i shëndetsisë për banorët e zonave të vërshuara.....	50
Fotografia 45. Pamje nga vërshimet në Lisicë.....	50
Fotografia 46. Dëmet e shkaktuara në Komunën e Mitrovicës.....	51
Fotografia 47. Vizita e Kryeministrit të Kosovës dhe Kryetarit të Komunës së Mitrovicës.....	51
Fotografia 48. Vizita e Kryeministrit të Kosovës dhe Kryetarit të Komunës së Mitrovicës në terren.....	52
Fotografia 49. Vërshimet në Komunën e Drenasit.....	52
Fotografia 50. Intervenimet në lumenjë.....	53
Fotografia 51. Reagimi gjatë vërshimeve.....	53
Fotografia 52. Reagimi gjatë vërshimeve.....	54
Fotografia 53. Reagimi gjatë vërshimeve.....	54
Fotografia 54. Reagimi gjatë vërshimeve.....	54
Fotografia 55. Shtabi Emergjent i Komunës së Podujevës.....	55
Fotografia 56. Dëmet e shkaktuara nga vërshimet.....	55
Fotografia 57. Makineria e nevojshme për të reaguuar.....	56
Fotografia 58. Dëmet e shkaktuara në biznese dhe shtëpi banimi.....	56
Fotografia 59. Dëmet e shkaktuara në infrastrukturë rrugore.....	56
Fotografia 60. Pastrimi i rrugëve nga kompanitë private.....	57
Fotografia 60. Rruga kryesore te Dudi Kersh.....	57
Fotografia 62. Lagjja e boshnjakëve.....	58
Fotografia 63. Në Mitrovicën Veriore.....	58
Fotografia 64. Vërshimet në Komunën e Leposaviqit.....	59
Fotografia 65. Vërshimet në Komunën e Leposaviqit.....	59
Fotografia 66. Dëmtimi i urës në Komunën e Leposaviqit.....	60
Fotografia 67. Vërshimet në fshatrat e Komunës së Leposaviqit.....	60
Fotografia 68. Vërshimet në Komunën e Zveçanit.....	61
Fotografia 69. Dëmtimi i rrugëve nga vërshimet në Komunën e Zveçanit.....	61
Fotografia 70. Dëmtimi i urave në Komunën e Zveçanit.....	62
Fotografia 69. Dëmtimi i rrugëve nga vërshimet në Komunën e Zveçanit.....	62
Fotografia 72. Vërshimet në Komunën e Zubin Potokut.....	63
Fotografia 73. Gjatë intervenimit në Komunën e Zubin Potokut.....	63
Fotografia 74. Qytetari në kohën e vërshimeve në Komunën e Zubin Potokut.....	64
Fotografia 75. Takim me zyrtarët e Komunës së Skenderajt.....	65
Fotografia 76. Vërshimet në qytetin e Skenderajt.....	65
Fotografia 77. Dëmtimet në infrastrukturën rrugore dhe biznese në Komunën e Skenderajt.....	66
Fotografia 78. Pamje nga vërshimet në Komunën e Skenderajt.....	66
Fotografia 79. Ndihma për banorët e prekur nga vërshimet.....	67
Fotografia 80. Mobilizimi i ndihmave për banorët e prekur nga vërshimet.....	67
Fotografia 81. Organizimi dhe mobilizimi për grumbullimin e produkteve ushqimore.....	68
Fotografia 82. Pastrimi i rrugëve dhe objekteve nga mbetjet e vërshimeve.....	68
Fotografia 83. Pamje nga demtimi i urës nga vërshimet në K. Skenderaj.....	69
Fotografia 84. Pamje gjatë solidarizimit me banorët e prekur nga vërshimet.....	69
Fotografia 85 Vizita e Kryetarit të Komunës së Klinës Z. Zenun Elezaj në terren.....	70

Fotografia 85 Pamje nga vërshimet në Komunën e Klinës.....	70
Fotografia 87 Invervenimi i zjarrëfiksive gjatë vërshimeve në Komunën e Klinës.....	71
Fotografia 88 Objekti i Komunës së Klinës	71
Fotografia 89 Vizita e Presidentes së Kosovës me Kryetarin e Komunës së Klinës.....	72
Fotografia 90 Vizita e Presidentes dhe Kryetarit të Komunës në terren.....	72
Fotografia 91 Intervenimi i banorëve gjatë vërshimeve	73
Fotografia 92 Vizita e Kryetarit të Komunës së Klinës gjatë intervenimit për mbrojtjen nga vërshimet.....	73
Fotografia 93 Takimi i Kryetarit të Klinës me Ministrin e Bujqësisë në terren.....	74
Fotografia 93 Takimi i Kryetarit të Klinës me Ministrin e Bujqësisë në zyret e Komunës.....	74
Fotografia 93 Kryetarit të Klinës me Ministrin e Bujqësisë takim me banorët e prekur nga vërshimet.....	75
Fotografia 96. Takim me Kryetarin e Komunës së Istogut	75
Fotografia 97. Kryetarit i Komunës së Istogut në takim me zyrtarë.....	76
Fotografia 98. Kryetarit i Komunës së Istogut me Ministrin e Bujqësisë në takim	77
Fotografia 99. Mobilizimi i Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit.....	77
Fotografia 100. Shpërndarja e ndihmave të banoirët e prekur nga vërshimet.....	78
Fotografia 101. Kryetarit i Komunës në takim me Grupin Parlamentar të LDK-së	78
Fotografia 102. Pamje të dëmeve në Komunën e Deçanit.....	79
Fotografia 103. Vërshimet në Komunën e Deçanit	79
Fotografia 104. Puntorët duke pastruar mbetjet nga vërshimet në Komunën e Deçanit	80



1. HYRJE

1.1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i përgatitur përfshin periudhën kohore të vërsimeve me datë 20-22 nëntor 2022. Raporti është bërë me qëllim të **regjistrimit të zonave të vërsuara** në territorin e Republikës Kosovës duke u bazuar në informatat e të gjithë akterëve relevant.

Të dhënat e këtij raporti janë nxjerrë nga raportet e drejtorive komunale, ku janë dhënë informacione për vërsime në toka bujqesore, në shtëpi private, infrastrukturë dhe ekonomi familjare.

Qëllimi bazë i këtij raporti është vlerësimi i këtyre vërsimeve të fundit në Kosovë, si dhe nxjerrja e përfundimeve dhe rekomandimeve për të shtuar ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e gjithë aktorëve përgjegjës.

Vërsimet përfshijnë gati çdo vit sipërfaqet e fushave në Kosovë, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme ekonomike dhe mjedisore. Shumica e lumenjëve nuk kanë shtretër që mund t'i pranojnë plotat maksimale dhe si pasojë kemi vërsimet të përmasave të këtilla. Gjendja në terrenet e vërsuara është e ilustruar edhe me anë të fotove brenda këtij raporti.

Kushtet natyrore të Kosovës janë të tilla, ku pjesët e rrafshta të territorit janë të përshtatshme dhe me potencial për shtrirjen e vendbanimeve, vendosjen e industrisë, zhvillimin e infrastrukturës, ndërsa malet që shtrihen për rreth ngriten gati vertikalisht, gjë që kushtëzon rrjedhjen e shpejt dhe me plota maksimale të ujë rrjedhave.

Karakteristikat e ndryshme morfologjike në terren, fushat e gjera të rrethuara me male, rezultojnë në intensitetin e shpejtë të vërsimeve që kategorizohen si vërsime të zgjeruara dhe dinamike dhe i përkasin vërsimeve të zgjeruara dhe dinamike.

Shtretërit e lumenjve janë relativisht të cekët, poashtu janë të parregulluar dhe të pa mirëmbajtur e hedhja e mbeturinave në shtretërit e lumenjve dhe shfrytëzimi i pakontrolluar i materialeve inerte nga shtretërit e lumenjve ndikojnë në përshkallëzimin dhe shkaktjnë vërsime në përmasa të mëdha në Kosovë.

Shfrytëzimi dhe plotësimi i këtyre hapësirave, përdorimi i tyre si dhe vlera e tyre e përgjithshme rritet, për çka rritet edhe nevoja për mbrojtje nga vërsimet.

Reshjet e shiut që kanë rënë pa ndalur me datë 20-22 nëntor 2022, kanë vënë në vërshtirësi pjesën më të madhe të komunave të pellgjeve lumore Drini i Bardhë dhe Ibër. Ka pasur dëmtime në infrastrukturë rurale, kryesisht rrugë dhe ura. Janë vërsuar ekonomi familjare, toka bujqësore, duke sjellur humbje të mëdha në sektorin e bujqësisë.

Për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga këto vërsime, janë formuar komisionet për Vlerësimin e Dëmeve nga kryetarët e komunave përkatëse dhe presim që në javët në vijim ekipet komunale të dalin me raporte të vlerësimit këtyre dëmeve.

Në figurën 1 dhe 2 janë paraqitur hartat lidhur me zonat me Rrezik Potencial Domethënës të Vërsimeve (ZRPDV) në të gjitha pellgjet lumore të Kosovës.

1.2. PËRMBLEDHJE KRYESORE

Pas reshjeve intensive gjatë periudhës 19-20 janar 2023 të cilat shkaktuan vërsime në disa zona që përfshijnë pellgun lumor Drini Bardhë dhe Ibrin. Në këtë rast të gjitha institucionet qendrore dhe lokale kanë qenë në gjendje gatishmërie dhe vepruan në bazë të kompetencave dhe përgjegjësisive ligjore për fatkeqësitë natyrore të shkaktuara nga vërsimet.

Në vazhdim është dhënë raporti përmbledhës për situatën e krijuar nga këto vërsime, i bazuar në informacionet e dhëna nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal, duke filluar nga momenti i paralajmërimit të vërsimeve deri në gjendjen pas vërsimit.




Figura 1. Zonat me Rrezik Potencial Domethënës të Vërsimeve




Figura 2. Zonat e ekspozuara të rrezikut potencial të vërsimeve në Kosovë



2. INSTITUTI HIDROMETEOROLOGJIK I KOSOVËS

2.1. PARALAJMRIMI PËR VËRSHIME

Me date 16 janar Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) lëshoi njoftim/komunikatë përmes web faqes <http://ihmk-rks.net/?page=1,40,44> dhe facebook të saj <https://ëëë.facebook.com/ihmk.rks/>, për informim të institucioneve dhe publikut në lidhje me mundësinë e vërshimeve në zona të caktuara të Kosovës. Në vazhdim është dhënë paralajmërimi për vërshime të shpejta të parashikuar nga IHMK:

Prishtinë:

Data e parashikimit: 16/01/2023 14 UTC

Fillimi i parashikuar i ngjarjes: E mërkurë, 18 janar 2023 - ora 00:00 Piku më i hershëm i parashikuar:

E mërkurë, 18 janar 2023 - 06:00 Njoftimi:

Duke filluar nga sot pasdite (e hënë, datë.16/01/2023) dhe gjatë ditës së nesërme dhe pasnesërme (e martë e mërkurë, datë.17-18/01/2023), pritet të ketë reshje me intensitet mesatarë deri në të lartë, të cilat do të jenë më të përqëndruara në pjesën perendimore dhe veriore të vendit, por gjatë ditës së nesërme ato do të përfshinë tërë vendin.

Në Dukagjin (Gjakovë, Junik, Deçan, Pejë, Istog, Prizren, Klinë, Zubin Potok etj), mund të ketë vërshime të shpejta të lumenjëve, fillimisht atyre të vegjël me karakterë të rrëkeve të cilët zbrasin prej viseve më të larta malore, duke pasur potencial për shembje apo rrëshqitje të dherave.

Në zonat urbane, në këto komuna, mund të shfaqen probleme me përmytje të lokalizuara, në varësi të gjendjes së sistemeve drenuese, mirëmbajtjes dhe pastrimit të shtetërve të lumenjëve dhe kanalizimeve.

Kjo situat pritet të ndikoj në ngritjen e niveleve dhe prurjeve të lumenjve kryesorë, veçanërisht të sistemit të lumit Drini i Bardhë, sidomos degët e tij të djathta, Ibri etj. Probabiliteti për të tejkaluar një prag 5-vjeçar të periudhës së kthimit: 55 %.

Probabiliteti për të tejkaluar një prag 20-vjeçar të periudhës së kthimit: 6 %.

Ky informacion, në varësi të situatës hidrologjike, do të përditësohet nga IHMK dhe do të njoftoheni për çdo ndryshim në parashikimin e rrezikut të përmytjeve.

Ky informacion do të përditësohet nga IHMK sipas nevojës.

Pas reshjeve të pandërprera të një intensiteti të lartë gjatë 17, 18 dhe 19 Janarit, ashtu sic ishte paralajmëruar nga IHMK, me 19 Janar 2023, vërshimet e para filluan në zonën veriperëndimore dhe perëndimore. Përsëri me datë 19 Janar IHMK lëshon njoftimin e radhës për informim të institucioneve dhe qytetarëve mbi gjendjen e krijuar dhe nivelet e ujërave në lumenjtë kryesorë të Kosovës nga reshjet e shiut. Në vazhdim është dhënë njoftimi i dytë i IHMK-së:



Tabela 1. Sasit e reshjeve nëpër disa Stacione Meteorologjike Automatike në Kosovë

Prishtinë: 19/01/2023, 09:00 UTC			
Njoftimi:			
<i>Si pasojë e reshjeve të shiut gjatë ditëve të fundit, sidomos në pjesën perendimore, veroperendimore dhe veriore të Kosovës, disa lumenjë kryesisht ata me karakter të rrëkeve, kanë paraqitur disa vërshime të shpejta, ndërsa nëpër disa segmente të lumenjëve kryesorë janë shkaktuar edhe përmbytje të lokalizuara lumore, të cilët mund të kenë shkaktuar vështirësi dhe probleme, si në rrëshqitje të dheut, mbyllje të kanalizimeve dhe vështirësi të qarkullimit, por edhe përmbytje të tokave bujqësore. Situata e vështërsuar hidrometeorologjike, pritet që të vazhdoj dhe gjatë ditëve në vijim, prandaj edhe nivelet dhe prurjet e lumenjëve, pritet të ngriten dhe të shkaktojnë vërshime/përmbytje.</i>			
Sasia e reshjeve nëpër disa Stacione Automatike Meteorologjike të Kosovës (Stacioni meteorologjik)	L.m.n.d.A	Reshjet (mm) 17/1012023	Reshjet (mm) 18/1012023
Prishtinë	573	13.0	11.9
Mitrovicë	500	18.0	39.2
Pejë	501	39.7	49.5
Gjakovë	467	18.0	13.6
Ferizaj	578	0.1	5.0
Kamenicë	474	0.1	2.6
Malishevë	556	17.9	9.5
Istog	464	23.0	76.1
Dragash	1048	11.7	9.0
Junik	618	134.2	55.3
Podujevë	632	0.4	5.5
Situata hidrologjike në disa nga lumenjtë kryesorë të Kosovës datë: 19/01/2023			

Lumi	Stacioni	Kuota "0" m	Niveli (m) 18/01/23 07:00	Niveli 24/h	Ndryshimi	Tendenca
Drini Bardhë	Gjonaj	333.71	3.64			▲
Drini Bardhë	Këpuz	393.95	2.72	4.17	1.45	▲
Bistrica Pejës	Grykë e Rugovës	595.10	1.70	1.71	0.10	▲
Ibri	Leposaviç	490.78	2.01	2.97	0.96	▲
Ibri	Mitrovicë	490.78	0.84	1.64	0.80	▲
Sitnica	Nedakoc	555.14	1.98	2.13	0.15	▲
Morava Binçës	Konçul	461.36	2.49	2.54	0.50	▲
Lepenci	Hani Elezit	395.62	0.76	0.77	0.10	—

Legjenda: Tendenca: (▲ ngritja, ▼ rënie, — konstant); ▲ Ngritje – (Tejkalim i kuotës normale); ▲ Ngritje - (Tejkalim i kuotës maksimale)



Situata vazhdoi të rëndohej duke u zgjëruar zonat vërshuese në pellgun e Drinit të Bardhë dhe në pellgun e Ibrit. Duke parë gjendjen e krijuar me këtë rast, përsëri IHMK informon institucionet dhe qytetarët për sasinë e reshjeve dhe nivelin e ujërave në lumenjë deri në ora 15 të datës 19 Janar 2023.

Në vazhdim është dhënë njoftimi i radhës i IHMK:

Tabela 2. Njoftimi i IHMK-së me datë 19/01/2023

Prishtinë: 19/01/2023, 15:00 UTC Nr. 03/ 2023 njoftimi:

Si pasojë e reshjeve të shiut të cilat janë duke vazhduar me intenzitet të lartë, sidomos në disa pjesë të vendit, (pjesa perendimore, veroperendimore, veriore dhe qendrore e Kosovës), disa lumenjë kanë dalur prej shtertërve të tyre dhe janë duke shkaktuar përmytje. Zonat më të prekura, janë ato në perendim të vendit, sidomos disa vendbanime në komunat si: Pejë, Junik, Deçani, Klinë, Skenderaj, Mitrovicë, Zubin Potok, Laposaviç etj. Situata e tillë e krijuar ka shkaktuar vështirësi dhe probleme, si në rrëshqitje të dheut, mbyllje të kanalizimeve dhe vështirësi të qarkullimit, por edhe përmytje të tokave bujqësore. Situata e vështërsuar hidrometeorologjike, pritet që të vazhdoj dhe gjatë orëve dhe ditëve në vijim.

Sasia e reshjeve nëpër disa stacione automatike meteorologjike të Kosovës

Stacioni meteorologjik	L.m.n.d.A	Reshjet (mm)		Reshjet (mm) 18/01/2023 07:00	Reshjet (mm) 18/01/2023 14:00
		17/01/2023	17/01/2023		
Prishtinë	573	13.0	13.0	11.9	0.2
Mitrovicë	500	18.0	18.0	39.2	-
Pejë	501	39.7	39.7	49.5	36.9
Gjakovë	467	18.0	18.0	13.6	15.4
Ferizaj	578	0.1	0.1	5.0	0.5
Kamenicë	474	0.1	0.1	2.6	6.3
Malishevë	556	17.9	17.9	9.5	0.2
Istog	464	23.0	23.0	76.1	37.9
Dragash	1048	11.7	11.7	9.0	6.8
Junik	618	134.2	134.2	55.3	45.7
Podujevë	632	0.4	0.4	5.5	3.6

Situata hidrologjike në disa nga lumenjtë kryesorë të Kosovës datë: 19/01/2023

Lumi	Stacioni	Kuota "0" m	Niveli (m) 18/01/23 07:00	Niveli (m) 19/01/2023		Tendenca
				07:00	14:00	
Drini Bardhë	Gjonaj	333.71	3.64	4.87	4.75	-0.12 ▼
Drini Bardhë	Këpuz	393.95	2.72	4.17	4.65	0.48 ▲
Bistrica Pejës	Grykë e Rugovës	595.10	1.70	1.71	1.72	0.01 ▲
Ibri	Laposaviç	490.78	2.01	2.97	4.39	1.42 ▲
Ibri	Mitrovicë	490.78	0.84	1.64	2.29	0.65 ▲
Sitnica	Nedakoc	555.14	1.98	2.13	2.29	0.16 ▲
Morava Binçës	Konçul	461.36	2.49	2.54	2.54	0.00 ▲
Lepenci	Hani Elezit	395.62	0.76	0.77	0.67	0.10 ▲

Legjenda: Tendenca: (▲ ngritja, ▼ rënie, — konstant)

▲ Ngritje – (Tejkalim i kuotës normale)

▲ Ngritje - (Tejkalim i kuotës maksimale)



Sipas informimit nga IHMK, reshjet vazhduan edhe gjatë 24 orëve të fundit të datës 19 janar e të cilat kishin përfshirë tërë territorin e Kosovës por në disa zona ishin të një intenziteti të lartë, të cilat shkaktuan vërshime të shpejta dhe të paparashikuara. Duke e parë situatën që nga momenti në moment përkeqësohej, IHMK në vazhdimësi monitoronte nivelin e ujërave në lumenjë dhe reshjet e shiut. Për më shumë mbi gjendjen e krijuar në lumenjë të Kosovës dhe për parashikimin e situatës hidrologjike, shih njoftimin e IHMK në vazhdim.




Figura 3. Situata Meteorologjike gjatë ditëve në vijim





Figura 4. Probabiliteti që parashikimet e përmbytjeve të tejkalojnë pragun e periudhës së kthimit 5 – vjeçar të EFAS. Gama e parashikimit 0-48 orë



3. MINISTERIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS

3.1. KOMUNIKATA

Pas reshjeve të pa ndërprera të shiut dhe vërshimeve eventuale, zyrtarë nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës kanë dalur në terren për të parë nga afër gjendjen e krijuar, me ç'rast janë duke u marrë masa për pastrimin e të gjitha rrugëve. Kompanitë e MVD-së të kontraktuara nga MMPHI-ja, janë në terren për pastrimin e akseve, normalizimin e qarkullimit rrugor dhe garantimin e sigurisë për drejtuesit e automjeteve që nga orët e hershme të mëngjesit.


U bëjmë thirrje të gjithë qytetarëve në zonat e rrezikuara që të bëjnë kujdes me lëvizjet e tyre në orët në vijim, të shmangin kalimet në rrugët me prezencë uji, të respektojnë rregullat e qarkullimit rrugor dhe të njoftojnë strukturat vendore për ndihmë të nevojshme.

Ministria është duke bërë Hartat e Rrezikshmërisë nga Përmbytjet dhe hartimin e Planeve për Menaxhimin e Rrezikut nga Përmbytjet dhe Thatësirat, në mënyrë që në situata të tilla të jemi shumë më të përgatitur, dhe të përmirësojmë kapacitetet parandaluese dhe reaguese për situata të ngjajshme.

3.2. VIZITA E MINISTRIT Z. LIBURN ALIU NË KOMUNËN E SKENDERAJIT DHE MITROVICËS

Me datë 20.01.2023 Rrugën Mitrovicë - Zubin Potok, përkatësisht në fshatin Zubç ku dje ka pasur shembje të dheut, që sot menjëherë është pastruar.

Kompania përgjegjëse e kontraktuar nga MMPHI, ka dalur në terren me ç'rast janë marrë të gjitha masat për zhblokimin e këtij aksi rrugor, normalizimin e qarkullimit rrugor dhe garantimin e sigurisë për drejtuesit e automjeteve. (shih foto 3).



Fotografia 1. Pastrimi i rrugës në fshatin Zubç

Lusim qytetarët për kujdes më të shtuar në orët e ditët në vijim, të shmangin kalimet në rrugët me prezencë uji, e të respektojnë rregullat e qarkullimit rrugor.

Vizita në Skenderaj për të parë nga afër dëmet e shkaktuara nga vërshimet e djeshme.



Fotografia 2. Takim me qytetarët e Komunës së Skenderajit

Vizituar vendet nga dëmet që janë shkaktuar në qytet dhe në fshatrat Llaushë, Tushilë, Rezallë e Re dhe disa pjesë tjera të Skenderajit. Po bëjmë të pamundurën për të sanuar situatën e krijuar, dhe fatmirësisht përpos dëmeve të konsiderueshme materiale nuk kemi qytetarë të vdekur e as të lënduar.

Kemi krijuar grupet ndërministrorë për t'iu dalë në ndihmë të gjithë qytetarëve që kanë pësuar dëme materiale nga vërshimet e djeshme, dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe të gjitha institucionet shtetërore do të qëndrojnë pranë banorëve të komunave në çdo kohë për ti ndihmuar e mbështetur ata

3.3. VIZITA E Zv. MINISTRES ZNJ. LINDA ÇAVDËRBASHA NË KOMUNËN E KLINË, ISTOG DHE PEJË

Më 20.01.2023 Zv. Ministria Linda Çavdërbasha, gjatë ditës vizitoi Komunitat. Klinë, Istog dhe Pejë ku së bashku me kryetarët e komunave z. Zenun Elezaj, z. Ilir Ferati dhe z. Gazmend Muhaxheri shikuar nga afër dëmet e shkaktuara nga rreshjet e mëdha të shiut në qytete e fshatra. Agjensioni i Mneaxhimit të Emergjencave (AME) dhe kompanitë e kontraktuara nga MMPHI janë në dispozicion të vazhdueshëm për mbështetje në zhbllokimin e rrugëve dhe ofrimin e sigurisë tek qytetarët.



Fotografia 3. Takim me banorët e prekur nga vërshimet në K. Klinë

Nga kryetari i Klinës është njoftuar për dëmet e shkakëtuara nga lumi i Klinës në infrastruktur, biznes, bujqesi dhe ekonomi familjare, dëmet janë të mëdha, andaj ne shresojmë në ndihmë nga niveli qëndror.



Fotografia 4. Fshati Osojan 20.01.2023



Fotografia 5. Fshati Kernin 20 .01.2023



Në komunën e Istogut janë vizituar fshati Osojan dhe Kernin, në fshatin Osojan është shkaktuar rrëshqitje e dheut dhe rruga ka qenë e mbyllur, ndërsa në fshatin Kërnin është dëmtuar ura.



Fotografia 6. Në komunën e Pejës dhe në fshatin Radocf 20.01.202


Për komunën e Pejës nga kryetari jemi njoftuar mbi dëmet e shkaktuara. Në qytet për shkak masave të ndërmarra në mirëmbajtjen e kanalit Jazit nuk kemi pasur dëme, ndërsa në fshatin Radocf është dëmtuar ura.

3.4. AUTORITETI I RAJONIT TË PELLGJEVE LUMORE

Me datë 19.01.2023, pas paralajmërimit të vërsimeve nga IHMK dhe krijimit të situatës në terren nga të reshurat atmosferike, si rezultat i reshjeve intensive janë shkaktuar vërsimeve në disa pjesë të Republikës së Kosovës. Një pjesë e stafit të ARPL, në përbërje nga: Sylejmon Latifi, Gafurr Dakaj dhe Argjend Hajra duke filluar nga ora 15:00, janë nisur për të vizituar qytetin e Mitrovicës dhe Skenderajit.

Ndërsa e parë ka qenë në qendrën operative në kampin Belveder, rreth orës 15:55 ku aty janë takuar me zotëri Xhevdet Smakiqin, udhëheqës në njësin operative i cili i ka informuar rreth gjendjes së vërsimeve në këto dy qytete të cilat kanë qenë të prekura më shumë. Po ashtu, sa i përket qytetit të Mitrovicës fillimisht është njoftuar se gjendja më e rënduar ka qenë në pjesën veriore të Mitrovicës në lokacioni Bernjak – Zupç, ku edhe është shpallur gjendje emergjente. Në vendin e ngjarjes ka qenë prezente edhe kompania Alko Impeks e kontraktuar nga Ministria e Infrastrukturës.

Pas këtij takimi, vizita e parë ka qenë në fshatin Lisic ku aty kemi hasur në disa familje, shtëpitë e të cilëve janë përmbytur nga vërsimet dhe si pasojë i kësaj, kanë kërkuar ndihmë emergjente për evakuim, me që janë kontaktuar të gjitha ekipet emergjente për të ju ardhur në ndihmë (Shih foton 7).



Fotografia 7. Fshati Lisicë, K. Mitrovicë (19.01.2023)

Ndalesa e dytë ka qenë në udhëkryqin e qendrës së Mitrovicës, ku prezent ishin edhe njësitë policore të cilët ndalonin hyrjen në qytet për shkak të vërshimeve të mëdha dhe pamundësisë për të lëvizur (shih foton 8).



Fotografia 8. Qyteti i Mitrovicë (19.01.2023)

Ndalesa e tretë ka qenë te lumi Lushta, i cili po ashtu është edhe lumi kryesor që ka shkaktuar vërshimet në qytetin e Mitrovicës (shih foton 9).



Fotografia 9. Lumi Lushta (Mitrovicë, 19.01.2023)




Pas përfundimit të vizitës në pikat ku këmi pasur mundësi të depërtojmë, kemi vazhduar rrugën për në qytetin e Skenderajit ku jemi prituar nga z. Sokol Hoxha, udhëheqës i emergjencave në komunën e Skenderajit. Fillimisht na ka njoftuar për gjendjen e shkaktuar nga vërshimet ku sipas tij, dy lumenjtë Lumi Klina, Lumi Qubrel si dhe Përroi i Keq kanë qenë shkaktarët kryesorë të vërshimeve në këtë komunë. Në vendin e ngjarjes përveç zyrtarve të komunës prezent kanë qenë edhe kompanitë private, të cilët kanë ardhur në ndihmë banorëve përreth, siç janë: Kompania Ndërtimi, Lirigzoni, Haxha, Rukolli, Zejnullahu etj. Ndalesa e parë ka qenë në fshatin Llaush afër rrugës Halil Bajraktari, ku ekipi i emergjencave të komunës ishin prezent në vendngjarje për të evakuuar një familje e cila kishte mbetur e ngjuar në shtëpi (shih foton 10).



Fotografia 10. Fshati Llaush (Skenderaj, 19.01.2023)

Ndalesa e dytë ka qenë në lagjen Fidanishte, ku e gjithë lagjia ka qenë e përmbytur dhe sipas informatave të zyrtarëve, afërsisht 600 banorë nga komuna e Skenderajit dhe fshatrave përreth janë evakuuar. Po ashtu edhe dy shkollat e mesme dhe një filllore kanë qenë të mbushura me ujë në katet përdhese. Parku i Biznesit në Skenderaj, Stadiumi, ETC-ja, Viva Fresh Store dhe shumë biznese kanë qenë të përmbytura. Sipas të dhënave fshatrat e përmbytura deri në orët e pasdites respektivisht intervalit 19:00-20:00, fshatrat e përmbytura kanë qenë (Kuçica, Klina, Qubrel, Llausha, Klladërnice, Turigec, Kopiliq, Tushec, Tërnac). Si në foton 10.



Fotografia 11. Sheshi Ilaz Kodra Skenderaj (19.01.2023)

Në përmbyllje të vizitës, së bashku me ekipin e emergjencave kemi takuar edhe kryetarin e komunës së Skenderajit Z. Fadil Nura dhe kabinetin e tij, për tu informuar më shumë mbi gjendjen e shkaktuar nga vërshimet në Komunën e Skenderajit (shih foton 11).

3.5. VIZITË NË KOMUNËN E SKENDERAJIT ME EKSPERTËT NDËRKOMBËTAR TË PROJEKTIT “HARTAT E RREZIKUT DHE RREZIKSHMËRISË NGA VËRSHIMET NË KOSOVË”

Vizita në terren është realizuar ditën e dielë, me datë 22 janar 2023, me kërkesën e Udhëheqësit të ARPL-së dhe të Kabinetit të Ministrit të MMPHI, z. Aliu. Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i gjendjes pas vërshimeve në komunën e Skenderajit nga zyrtarët e MMPHI/ARPL dhe ekspertet e kompanisë konsulente COVI të projektit “Hartat e Rrezikut dhe Rrezikshmërisë nga Vërshimet për të gjithat pellgjet lumore në Kosovë” të financuar nga WBIF. Poashtu gjatë vizitës është bërë incizimi me dron i dëmeve nga vërshimet e shkaktuara nga dalja e lumit Klina prej shtratit. Pjesëmarrësit në këtë vizitë ishin zyrtari për Ndryshime Klimatike, Thatësira dhe Vërshime, z. Sylejmon Latifi, ekspertet e projektit, udhëheqësja e ekipit të projektit, znj. Zsuzsanna Lehoczki, zëvendësuesja e udhëheqëses së ekipit, znj. Visnja Omerbegovic dhe profesionisti i ri, z. Lorik Lajçi.

Puna në terren ka rrjedhur si vijon:

Fillimisht jemi pritur në objektin e komunës së Skenderajit nga zëdhënësi i komunës, kryetari i komunës, z. Fadil Nura dhe nënkryetari kryetari i komunës së Skenderajit, z. Sami Lushtaku. Së pari ata na njoftuan për gjendjen e krijuar nga vërshimet në komunë, dëmet e shkaktuara dhe mënyrën se si komuna me kapacitetet e tyre modeste kanë menaxhuar situatën e krijuar. Komuna ka dalë në ndihmë qytetarëve përmes angazhimit të të gjithat resurseve humane dhe makinerive me eskavatore për të evakuuar njerëzit që ishin bllokuar nga vërshimet.



Fotografia 12. Takimi me kryetarin dhe nënkryetarin e komunës së Skenderajit, z. Nura dhe z. Lushtaku

Z. Latifi prezantoi veprimet që ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës, respektivisht Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në kontekstin e mbrojtjes nga vërshime. Ministria është angazhuar me prioritet në përmbushjen e obligimeve ligjore, që nënkupton hartimin e Planeve të Menaxhimit të Rrezikut nga Vërshimet, që është një proces i cili përfshinë disa faza.

Faza e parë ka përfshirë Vlerësimin Paraprak të Rrezikut nga Vërshimet, i cili është një burim kryesor i informacionit për hartat e rrezikut dhe rrezikshmërisë nga vërshimet. Kjo fazë tashmë është përfunduar me sukses.

Faza e dytë, proces në të cilin jemi duke punuar në mënyrë intensive në bashkëpunim me ekspertet e COVI/ËBIF. Ky proces është kompletimi i Hartave të Rrezikshmërisë dhe Hartave të Rrezikut nga Vërshimet.

Projekti është duke u implementuar përmes mbështetjes financiare nga WBIF ("Western Balkan Infrastructure Facility"). Ky projekt tani është në fazën e përgatitjes për incizimin e zonave me potencial të lartë vërshues. Këto zona janë gjithsejt në sipërfaqe prej 351 km². Incizimi i detajuar i këtyre zonave do të bëhet me teknologjinë e fundit LIDAR.



Kryetari dhe nënkryetari i komunës na prezentuan me zyrtarin përgjegjës, shefin e emergjencave, z. Sokol Hoxha. Pas takimit me zyrtarin përgjegjës për çështjen në fjalë, ne vazhduam me vizitën në terren së bashku me zyrtarin e emergjencave. Në bashkepunim me shefin e emergjencave në vizituam zonat me dëmet e shkaktuara nga vërshimet e datës 19-20 janar 2023, në të gjithë zonën ekstra-urbane të komunës së Skenderajit.



Fotografia 13. Takimi me zyrtarin e emergjencave z. Sokol Hoxha

Më pas kemi vizituar qendrën për ndihma dhe emergjenca në komunën e Skenderajit, ku u takuam me drejtorë të departamenteve dhe përfaqësues të ndryshëm komunal, pjesëtarë të shoqërisë civile, qytetarë të thjeshtë dhe vullnetarë që u angazhuan në përmirësimin e gjendjes së krijuar.



Fotografia 14. Takimi me drejtorët e departamenteve dhe përfaqësues të ndryshëm të Komunës

Pas takimit me përfaqësuesit e komunës, ne kemi vazhduar vizitën në terren në zonat e prekura nga vërshimet dhe zonat në të cilat janë shkaktuar dëmet. Ne kemi bërë incizimin e parë në zonën ekstra-urbane të komunës së Skenderajit në mënyrë automatike dhe në mënyrë manuale. Pasi që ky incizim përfundoi me sukses, kemi dalë nga zona ekstra-urbane e komunës dhe vazhduam me incizimin e dëmeve të shkaktuara tek lagjet dhe shtëpitë e banimit, të cilat mund të vlerësohen nga fotot e dronit se dëmet e shkaktuara janë jashtëzakonisht të mëdha.



Fotografia 15. Fotografi nga droni të shtratit të lumit Klina dhe daljes së tij nga shtrati

Pas përfundimit të misionit automatik të fluturimit mund të themi se tash kemi një pasqyrë për dëmet nga vërshimet e shkaktuara nga dalja e shtratit të e lumit Klina.



Fotografia 16. Fotografi nga droni të dëmeve të shkaktuara nga dalja e shtratit të lumit Klina



Fotografia 17. Vëzhgim me dron të dëmeve të shkaktuara në qendrën e qytetit dhe foto e ekipit të terrenit

Me përfundimin e incizimeve “mapping”, është bërë edhe një video incizim të dëmeve të shkaktuara nga dalja e lumi Klina nga prej shtrati në komunën e Skenderajit. Më pas është bërë editimi i video incizimit dhe përgatitja për publikim në rrjetet sociale të ARPL-së dhe MMPHI-së.

4. MINISTERIA E PUNËVE TË BRENDSHME - AGJENCIA E MENAXHIMIT EMERGJENT

4.1. MINISTERIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Ministria e Punëve të Brendshme ka ngritur gatishmërinë shtetërore me rastin e vërshimeve që kanë ndodhur me datë 19.01.2023.

Sot, që nga orët e para të ditës kanë filluar reshjet atmosferike të shiut, me ç'rast në Rajonin e Mitrovicës dhe Pejës ka pasur ngritje të nivelit të ujit në lumenj dhe ka pasur vërshime të shpejta.

Agjencia e Menaxhimit Emergjent, në kuadër të MPB-së në koordinim me IHMK-në ka marrë të gjitha masat e nevojshme duke ngritur nivelin e gatishmërisë në të gjitha komunat. Aktualisht, MPB është mobilizuar me të gjitha kapacitetet e saj, përfshirë AME-në me të gjitha Njësitë e Zjarrfikësve dhe Policinë e Kosovës, të cilët do të jenë në shërbim të qytetarëve 24 orë.

Ministria e Punëve të Brendshme është në komunikim dhe koordinim me të gjitha ministrinë tjera, për marrjen e të gjitha masave për përbalimin sa më të lehtë të situatës.

Apelojmë tek qytetarët që jetojnë në zona ku ka përmytje që të kenë kujdes të shtuar dhe të komunikojnë me autoritetet shtetërore që t'iu vijnë në ndihmë. Qendrat Operative Emergjente janë aktivizuar në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës dhe për çdo urgjencë duhet të kontaktojnë në numrin emergjent 112. Ndërsa një raport i detajuar për situatën e krijuar nga vërshimet në vend, do të publikohet ndërkohë.

4.2. MINISTRI Z. SVEÇLA TAKOI KOORDINATOREN E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIM NË KOSOVË ZNJ. ARNHILD SPENCE

Më datë 23.01.2023, Ministri i Punëve të Brendshme Z. Xhelal Sveçla ka pritur në takim Koordinatoren e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Kosovë Znj. Arnhild Spence, ku diskutuan për gjendjen e përgjithshme pas vërshimeve që ndodhën në Kosovë.



Fotografia 18. Takim nga zyra e Ministrit Z. Sveçla

Me këtë rast, Ministri Z. Sveçla, e njoftoi Znj. Spence për gjendjen e përgjithshme për momentin në komunat ku ka pasur vërshime më të mëdha dhe veprimet e ndërmarra nga institucionet qendrore dhe lokale të Republikës së Kosovës. Ai theksoi se fatmirësisht nuk ka pasur viktima në njerëz, megjithatë theksoi se dëmet janë shumë të mëdha.

“Menjëherë pas fillimit të vërshimeve, MPB ka ngritur gatishmërinë shtetërore dhe ka bërë koordinimin e veprimeve së bashku me agjencitë ekzekutive dhe komunat, që fillimisht të evakujnë të gjithë banorët dhe të mos kemi viktima në njerëz”, theksoi ministri Sveçla.



Ministri poashtu, theksoi se në kuadër të Qendrës Operative të Ministrisë së Punëve të Brendshme po vijon koordinimi i intervenimeve në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Po ashtu po bëhet sigurimi i kërkesave të pranuar nga Shtabet Emergjente të komunave.

Ndërsa Koordinatorja e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Kosovë, znj. Arnhild Spence, e falënderoi ministrin Sveçla për rezymenë e përgjithshme për situatën pas vërshimeve dhe vuri në pah se UN ka gatishmëri që të ndihmojë familjet dhe qytetarët që janë prekur nga vërshimet.

Ditëve në vijim do të vazhdoj koordinimi me Zyrën e Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe agjencitë e saj, në mënyrë që të realizohen kërkesat dhe nevojat e pranuar nga komunat dhe nga qytetarët.

4.3. VEPRIMET OPERACIONELE ME RASTIN E VËRSHIMEVE

4.3.1. Raportet për Situatat e Vërshimeve

Prishtinë, 16 Janar 2023

Bazuar në paralajmërimin nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) për vërshime në ditët në vijim, dhe me qëllim të gatishmërisë së institucioneve dhe Strukturave për Mbrojtje Shpëtim dhe Ndihmë (SMSHN), Agjencia e Menaxhimit Emergjent, udhëzon për ngritje të gatishmërisë në nivel vendi për:

1. QOE 112- Qendrat Operative Emergjente 112
2. Njësitë Profesionale të Zjarrfikëse dhe Shpëtimit- NJPZSH si dhe Strukturat për Mbrojtje Shpëtim dhe Ndihmë – SMSHNJ,
3. Drejtoritë komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim.
4. Dhe kapacitetet e subjekteve relevante në nivel lokal dhe qendror.

Paralajmërimi për situatën është i ndërlidhur bazuar në parashikim i cili njofton se, nga parashikimi i IHMK-s "nga sot pasdite (e hënë, datë.16/01/2023) dhe gjatë ditës së nesërme dhe pasnesërme (e martë e mërkure, datë.17-18/01/2023), pritet të ketë reshje me intensitet mesatarë deri në të lartë, të cilat do të jenë më të përqendruara në pjesën perëndimore dhe veriore të vendit, por gjatë ditës së nesërme ato do të përfshinë tërë vendin.

Në Dukagjin (Gjakovë, Junik, Deçan, Pejë, Istog, Prizren, Klinë, Zubin Potok etj.), mund të ketë vërshime të shpejta të lumenjve, fillimisht atyre të vegjël me karaktere të rrëkeve të cilët zbrasin prej viseve më të larta malore, duke pasur potencial për shembje apo rrëshqitje të dheut. Në zonat urbane, në këto komuna, mund të shfaqen probleme me përmbajtje të lokalizuara, në varësi të gjendjes së sistemeve drenuese, mirëmbajtjes dhe pastrimit të shtretërve të lumenjve dhe kanalizimeve. Kjo situatë pritet të ndikoj në ngritjen e niveleve dhe prurjeve të lumenjve kryesorë, veçanërisht të sistemit të lumit Drini i Bardhë, sidomos degët e tij të djathta, lumi Ibër etj". Informatën e detajuar lidhur me paralajmërim nga IHMK - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës e gjeni të bashkëngjitur këtij paralajmërimi, ndërsa plotësimet me përditësime për situatë në ditët në vijim mund të i gjeni në likun e bashkëngjitur më poshtë në këtë komunikatë.

Situata: Me datë 19.01. 2021, një pjesë e territorit të Republikës së Kosovës është përfshirë nga shiu i cili shkaktoi vërshime sidomos në Regjionin e Pejës dhe Mitrovicës. Në këto vërshime u rrezikuan më së shumti Istogu, Klina, Mitrovica, Skenderaj dhe Komunat në Veri të Kosovës si Mitrovica, Zvecani dhe Zubin Potoku.

Veprimet e ndërmarra:

Pas marrjes së raportit për motin nga IHK-, AME fillimisht ka bërë vlerësimin e situatës dhe ka marrë këto veprime:

- Ngritja nivelit të gatishmërisë emergjente të QOE112 për tërë Kosovën, prandaj në kuadër të këtyre qendrave janë angazhuar edhe zyrtarë të tjerë të AME-se dhe në bashkëpunim me drejtoritë komunale kanë pasë për qëllim grumbullimin e informacioneve të shpejta dhe të sakta nga terreni;
- Të gjitha NJPZSH-te kanë ngritur nivelin e gatishmërisë dhe janë përforcuar me ekipe shtesë për t'u angazhuar në terren sipas gjendjes aktuale dhe vend ngjarjeve me rrezikshmëri më të lartë.



- Grumbullimi i të dhënave është bërë në mënyrë permanente nga Qendra Operative e AMEse, ku janë analizuar dhe janë marrë vendime sipas situatës në terren.
- Ministria e Brendshme ka qenë e informuar vazhdimisht, me qëllim që të vlerësohet gjendja aktuale, ndërmerren masat parandaluese dhe të reagohet në vendin e ngjarjes në mënyrë efikase dhe efektive.

Apel i AME-së

Të dashur qytetarë

Përballë kësaj situatë të krijuar nga të reshurat atmosferike, ju bëjmë thirrje të gjithëve për kujdes dhe vigjilencë të shtuar! Qendrat Operative Emergjente janë aktive 24/7, andaj ju lutemi që ti kontaktoni ato përmes numrit emergjent 112 (pa pagesë) rreth çdo vështirësie që mund të përballeni.

Situata aktuale pas vërsimeve:

Mbështetur nga të dhënat e QORE dhe Drejtoritë Komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim, situata më e rënduar nga vërshimet paraqitet në Regjionin e Pejës dhe Mitrovicës. Nga këto vërshime u rrezikuan më së shumti komunat: Istogu, Klina, Mitrovica, Skenderaj dhe Komunat në Veri të Kosovës: Mitrovica, Zvecani dhe Zubin Potoku. Te vërshuara nga reshjet atmosferike, por me intensitet me të ulte janë edhe regjionet e tjera, të cilat janë nën menaxhim dhe monitorim të plotë nga NJPZSH-te dhe QOE 112.

Në vazhdim janë raportet sipas Regjioneve:

Regjioni i Prishtinës: Situata në Prishtinë: sipas informacioneve të arritura nga DSHPE-te, NJPZSH-te, situata deri tash është si në vijim:

- Vërshim i rrugës nga reshjet atmosferike në lagjen e Verbovcëve fsh. Barilevë sidomos Lagja Leci; Reagimi i Njësisë:
- Në ora 02:11 nga z. Blerim Gashi- udhëheqës i ekipit për kërkim shpëtim në ujëra sipërfaqësore nga NJPZSH0 Prishtinë, njoftohemi se ekipet që kanë shkuar në ndihmë për intervenim në Komunat Mitrovicë, Istog dhe Klinë janë kthyer.
- Podujevë:** sipas informatave të arritura nga DSHPE, NJPZSH si dhe qytetarëve, situata deri me tash është si në vijim:
- Është kërkuar ndërprerje e energjisë elektrike sepse është rrezikuar një trafo elektrike nga vërshimet të ura në fshatin Sibovc;
- Nga vërshime në fshatin Sekiraq, sipas ankuesve është bllokuar ura nga mbeturinat dhe rrezikohen shtëpitë e banimit;
- Vërshim i një bodrumi rr. Brigadat nr.34 afër “Malësia-Petro!”;
- Shembje e gurëve në rrugë, rruga për fshatin Reçicë të restaurant “Demë Ahmeti” sipas policisë është bllokuar një shirit rrugor.

Drenas: sipas informacioneve të arritura nga DSHPE, NJPZSH dhe qytetarëve, situata deri me tani është si në vijim: Nuk kemi pranuar asnjë rast për intervenim.

Obiliq: sipas informacioneve të arritura nga DSHPE, NJPZSH si dhe qytetarëve, situata deri me tani është si në vijim. Nuk kemi pranuar asnjë rast për intervenim.

Lipjan: sipas informacioneve të arritura nga DSHPE, NJPZSH si dhe qytetarëve, situata deri me tash është si në vijim: Nuk kemi pranuar asnjë rast për intervenim.

Shtime: sipas informacioneve të arritura nga DSHPE si dhe NJPZSH dhe qytetarëve, situata deri me tash është si në vijim: Nuk kemi pranuar asnjë rast për intervenim.

Fushë Kosovë: sipas informacioneve të arritura nga DSHPE, NJPZSH si dhe qytetarëve situata deri me tash është si në vijim: Nuk kemi pranuar asnjë rast për intervenim.

Graçanicë: sipas informacioneve të arritura nga DSHPE, NJPZSH si dhe qytetarëve, situata deri me tash është si në vijim: Nuk kemi pranuar asnjë rast për intervenim.

Regjioni i Pejës: Si pasojë e reshjeve të shiut pas orës 19:00 gjendja është stabile dhe deri në ora 07:00 nuk kemi pranuar kërkesë për intervenim.



Gjakovë: kontaktuar me NJPZSH, dhe u njoftuar se gjendja pas të reshurave të shiut është stabile, nuk kanë pasur ndonjë kërkesë për intervenim nga ora 19:00 deri ne ora 07:00.

Deçan: Kontaktuar me NJPZSH, dhe u njoftuar se për shkak të të reshurave të shiut, kanë intervenuar në dy raste , terheqje të ujit nga podrumet e shtëpive.

Istog: Kontaktuar me NJPZSH, dhe u njoftuar se nga ora 19:00 deri ne 07:00 kanë pasur 6 raste intervenimi: Është bërë evakuimi i dy familjeve 8 anetarëshe. Ne ndihme NJPZSH – ve Istog ju kanë dalur edhe ekipet e FSK – se, të cilët kanë bërë evakuimin e 33 personave ku 2 prej tyre me vonë kanë kërkuar qe ekipet e NJPZSH – së ti kthejnë në shtëpitë e tyre, po ashtu NPZSH-te kanë bërë pompimin e ujit neper podrumet te shtëpive. Te gjithë personat qe kanë pasur nevoj me u evaku kanë qenë nga fshati Drejë dhe janë vendosur disa prej tyre tek familjaret, ndërsa të tjerët i kanë vendosur ne Q.K.M.F – Istog.

Klinë: Kontaktuar me NJPZSH, dhe u njoftuar se pas të reshurave të shiut është ngrit niveli i ujërave dhe gjendja është me sa vijon: - NJPZSH Klinë kanë bërë evakuimin e 40-50 familjeve, nga lagjet: Malushgan, Dukagjini, kanë bërë tërheqjen e 4 veturave në fshatin Gjurgjevik, të Guri i Zi, në afërsi të stacionit policor në Klinë dhe në fshatin Shtaric kanë bërë tërheqjen e dy personave nga vetura, ndërsa vetura ka mbetur në vend ngjarje, dhe po ashtu kanë pasur disa intervenime për tërheqje të ujit nëpër shtëpi. Në ndihmë NJPZSH – Klinë ju kanë dale NJPZSH e Prishtinës me 7 pjestarë, Suhareka me 3 pjestarë, Gjakova me 3 pjestarë dhe Rahoveci me 3 pjesëtarë, të cilët kanë intervenuar por nuk janë takuar me NJPZSH – Klinë.

Juniku: Kontaktuar me NJPZSH, dhe u njoftuar se është ngitur niveli i ujërave, por nga ora 19:00 deri në ora 07:00 nuk kanë pranuar ndonjë kërkesë për intervenim.

Regjionin e Prizrenit: Gjendja nga të reshurat në Regjionin e Prizrenit sipas njësive të NJPZSH-ve të (Drejtorive Komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim), datës 20.01.2023, ora 08:00.

- Prizren** – NJ.P.Z.SH – Nuk kanë pasur asnjë intervenim;
- Suharekë** – NJ.P.Z.SH – Nuk kanë pasur asnjë intervenim;
- Malishevë** – NJ.P.Z.SH – Nuk kanë pasur asnjë intervenim;
- Rahovec** – NJ.P.Z.SH –Nuk kanë pasur asnjë intervenim;
- Dragash** – NJ.P.Z.SH – Nuk kanë pasur asnjë intervenim;
- Mamushë** – NJ.P.Z.SH – Nuk kanë pasur asnjë intervenim.

Situata në Regjionin e Prizrenit vazhdon të jetë e qetë, nuk ka asnjë intervenim lidhur me vërshimet në terren.

Regjioni Mitrovicës Jug: Gjendja momentale, për shkak të reshurave të shumta të shiut, është rritur niveli i lumenjve dhe kemi pasur vërshime, gjithsej 09 Raste: Vërshime pati në sheshin Adem Jashari, në lagjen Fidanisht afër Xhamisë, në lagjen Bair, rr: Sali Rama, fsh. Broboniq, Intervenimet: Te palestra Minatori kanë intervenuar forcat e Drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim dhe NJPZSH-te. Policia e Kosovës dhe KEDS-i; Rrugët e qytetit janë të kalueshme.

Vushtrri: Gjendja momentale: Nuk pati raste për intervenim.

Skenderaj: Gjendja momentale për shkak të reshurave të shumta të shiut ka pasur vërshime: në lagjen Salimi, fshati Kuqicë; Rrugët e qytetit janë të kalueshme.

Në të gjitha këto raste kanë intervenuar Drejtoria Komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim, NJPZSH-te, PK, dhe KEDS.

Regjioni i Gjilanit: Gjendja momentale është e qetë dhe pa të reshura të shiut, mirëpo NJPZSH janë në stacion të gatshëm për të intervenuar në rast nevoje.

Ferizaj: Gjendja momentale është e qetë dhe pa të reshura të shiut, mirëpo NJPZSH janë në stacion të gatshëm për të intervenuar në rast nevoje.

Viti: Gjendja momentale është e qetë dhe pa të reshura të shiut, mirëpo NJPZSH janë në stacion të gatshëm për të intervenuar në rast nevoje.



Kamenicë: Gjendja momentale është e qetë dhe pa të reshura të shiut, mirëpo NJPZSH janë në stacion të gatshëm për të intervenuar në rast nevoje.

Kaçanik: Gjendja momentale është e qetë dhe pa të reshura të shiut, mirëpo NJPZSH janë në stacion dhe të gatshëm për të intervenuar në rast nevoje.

Novobërdë: Gjendja momentale është e qetë dhe pa të reshura të shiut, mirëpo NJPZSH janë në stacion dhe të gatshme për të intervenuar në rast nevoje.

Hani i Elezit: Gjendja momentale është e qetë dhe pa të reshura të shiut, mirëpo NJPZSH janë në stacion dhe të gatshëm për të intervenuar në rast nevoje.

Regjioni Mitrovica Veri: Në territorin e komunës së Mitrovicës veri niveli i ujit të lumenjve Ibër dhe Sitnica është ende mjaft i lartë:

- Në Mëhallën e Boshnjakeve, 7 shtëpi janë ende të kërcënuara te rrezikuara dhe pjesërisht nën ujë, ndërsa uji dalëngadalë po largohet nga ndërtesat e përmbytura;
- Në rrugën Kolasinska rrëshqitja e dheut kryesisht është rregulluar dhe rruga është e kalueshme. Të gjithë punëtorët dhe makineritë në dispozicion nga Komuna Mitrovica Veri janë në terren. Gjatë ditës së djeshme janë evakuuar rreth 100 familje.

Zveçan: Në territorin e komunës së Zveçanit niveli i ujit të lumit Ibër është në stagnim, por në disa vende ka dalur nga uji. Sa i përket degëve të lumit Ibër dhe lumenjve më të vegjël, ato janë në rënie të lehtë, por rreth 40 shtëpi janë ende në rrezik. Rrëshqitjet e ndodhura dje janë riparuar dhe qarkullimi po zhvillohet pa probleme. Të gjithë punëtorët dhe makineritë në dispozicion nga Komuna Zveçanit janë në terren dhe plani është që të nxjerrin ujin nga shtëpitë e përmbytura.

Leposaviq: Në territorin e komunës së Leposaviqit niveli i ujit të lumit Ibër është i ndenjtur, por në disa vende ka dalë i tej mbushur, ndërsa më kritike është në fshatrat Kutnje dhe Donji Krnjin, ku rrugët janë të vërshuara dhe komunikacioni nuk qarkullon në ato rrugë. Sa i përket degëve të lumit Ibër dhe lumenjve më të vegjël, ato janë në rënie të lehtë, por rreth 20 shtëpi janë ende në rrezik. - Rrëshqitjet e ndodhura ditën e djeshme janë riparuar dhe qarkullimi po zhvillohet pa probleme në ato rrugë. Të gjithë punëtorët dhe makineritë në dispozicion nga Leposaviqi janë në terren. Gjatë ditës së djeshme janë evakuuar 4 familje.

Zubin Potok: Në territorin e komunës së Zubin Potokut niveli i ujit të lumit Ibër ka ngecur dhe është në prag të vërshimit. Sa i përket degëve të lumit Ibër dhe lumenjve më të vegjël, ato janë në rënie të lehtë, por rreth 30 shtëpi janë ende në rrezik. Ujësjellësi dhe kanalizimi që ishte në qendër të qytetit po tërhiqet dalëngadalë. Rrëshqitja e dheut në fshatin Varage është riparuar dhe qarkullimi po zhvillohet pa probleme. Të gjithë punëtorët dhe makineritë në dispozicion nga Zubin Potoku janë në teren.

Prishtinë 22 Janar 2023.

Mbështetur nga informacionet e arritura nga sistemi i komunikimit emergjent QOE 112, në koordinimin dhe menaxhim me situatë vërshimesh, të cilat goditën pjesët veri dhe veri -perëndimore të vendit, aktualisht gjendja paraqitet e lehtësuar!

Kryesisht veprimet e ndërmarra në zona të goditura sipas raportit të fundit të datës 22 Janar 2023 janë të natyrës së vlerësimit të dëmeve dhe operacionet e rimëkëmbjes pas goditjes së fatkeqësisë, me përjashtime ku njësi të specializuara në hapjen e rrugëve të dëmtuar nga rrëshqitja e dheut dhe gurëve si pasojë e të reshurave nga dt. 17 Janar 2023. Agjencia e Menaxhimit Emergjent MPB me të gjitha kapacitet në dispozicion, nga data e paralajmërimit nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës për parashikim të përkeqësimit të situatës, ndërmerr veprimet bazuar në misionin e saj në ngritjen e gatishmërisë në dy nivelet e qeverisjes së vendit lokal dhe atë qendrorë. Ndërlidhur me këtë, veprimet e ndërmarra ishin:

1. Vendosja e gjithë kapacitetit koordinues (Qendrat Operative Emergjente QOE 112, dhe QO AME-s), dhe reagues në nivelin e gatishmërisë së lartë (Njësitë Profesionale të Zjarrëfikjes dhe Shpëtim-it-NJPZSH, si dhe Modulet e KSH në Ujëra Sipërfaqësorë dhe Pompimimit me Kapacitet të Lartë-PKL);



2. Koordinimi i ndihmës dhe mbështetje për zonat e goditura, si nga kapaciteti në dispozicion i Agjencisë Menaxhimit Emergjent, Kryqi i Kuq i Kosovës, FSK me kapacitetin për evakuim dhe shpëtim, Policinë e Kosovës dhe shërbimet tjera në nivel komunal dhe qendror;
3. Përcjelljen e situatës dhe koordinimin e mbështetjes nga shtetet fqinje, në veçanti nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile Republikës Shqiptarisë, e cila vendosi në gatishmëri resurset për ndihmë dhe mbështetje R. Kosovës, si e tillë ende qëndron në gatishmëri për mbështetje, dhe
4. Shqyrtimin e ofertës nga ekspert për vlerësimin e dëmeve dhe ndihmës së menjëhershme për zonat e goditura, e ofruar nga subjekti i autorizuar i Bankës Botërore dhe Komisioni Evropian me mekanizmat e Kombeve të Bashkuara.

Nga ky raport i orëve të fundit konstatohet se gjendja në terren ka trend qetësimi në të gjitha komunat e goditura, ndërsa sistemi i komunikimit dhe koordinimit emergjent i Agjencisë Menaxhimit Emergjent dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme vazhdon të mbajë gjendjen e gatishmërisë së lartë operacionale, duke ofruar ndihmë dhe mbështetje 24/7 në koordinim me të gjithë kapacitetin vendorë lokal dhe qendror për lehtësim të vazhdueshëm të gjendjes.

Apelet nga Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik- IKSHP për vlimin e ujit për pije, përdorim mbeten në fuqi deri në një lajmërim të radhës, ndërsa plotësimet për parashikimin e motit dhe veprimet e ndërmarra në harmoni me rekomandimet e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës IHKM janë të përhershme.



Fotografia 19. Gjatë intervenimit në terren

Qytetarët e vendit udhëzohen të mbajnë komunikimin e vazhduar me QOE 112 në numrin emergjent pa pagesë 112 24/7 për nevoja emergjente. Agjencia do të bëjë më të mirën e mundshme për ndihmë dhe lehtësim zonave të goditura.



5. MINISTRIA E MBROJTJES E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

5.1. MINISTRI Z. MEHAJ – VIZIT NË KOMUNËN E MITROVICËS

Me datë 19.01.2023, pas reshjeve të mëdha që po vazhdojnë dhe vërshime në shumë pjesë të vendit, autoritetet tona zyrtare janë duke e monitoruar pandërprerë situatën në terren.

Ministria e Mbrojtjes, bazuar në Planin e Reagimit Kombëtar në Emergjencë, është në gatishmëri të plotë të reagoj, varësisht nga kërkesat për mbështetje të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave.

FSK si çdo herë, në secilën situatë emergjente është e gatshme plotësisht, me të gjitha kapacitetet e saj në dispozicion që të realizoj detyrën ligjore të mbështetjes ushtarake të autoriteteve civile dhe qytetarëve tanë pa dallim.



Fotografia 20. Reagimi i FSK në Komunën e Mitrovicës

Me qëllim të njohjes nga afër me situatën e krijuar pas përmbajtjeve të sotme, Ministri i Mbrojtjes, Z. Armend Mehaj vizitoi sonte Mitrovicën ku u takua me kryetarin e komunës Z. Bedri Hamza. Me këtë rast, Ministri Z. Mehaj theksoi se situata në vendin tonë është nën kontroll dhe se me gjithë vështirësitë në terren, ushtarët me sukses po i u dalin në ndihmë qytetarëve. Në takim me Kryetarin Z. Hamza, gjithashtu diskutuan për masat që duhet të ndërmerren në vazhdim, ku ndër të tjera Ministri Z. Mehaj njoftoi se kemi lajme të mira nga terreni ku niveli i ujit po bie dhe gjendja po shkon drejtë normalizimit.

Gjithashtu, Ministri Z. Mehaj njoftoi se forcat tona janë aktualisht në operacion, në ndihmë dhe dispozicion të qytetarëve në Skenderaj, Istog dhe Klinë. Ai, gjithashtu e njoftoi Kryetarin e Komunës së Junikut që në rast nevojë jemi në gatishmëri të plotë për mbështetje dhe ndihmë qytetarëve.

"Ushtria jonë është në çdo sfidë, në çdo kohë dhe secilën situatë pranë dhe me ju!" ishte në fund mesazhi i Ministrisë Mehaj drejtuar autoriteteve dhe qytetarëve të vendit.



Fotografia 21. Takimi në terren i Ministrisë Z. Mehaj me Kryetarin e K. Mitrovicës Z. Hamza


5.2. KRYEMINISTRI Z. KURTI, MINISTRI Z. MEHAJ, MINISTRI Z. KRASNIQI – VIZIT NË KOMUNËN E KLINËS DHE ISTOGUT

Kryeministrin e Republikës së Kosovës Z. Albin Kurti i shoqëruar me Ministri i Mbrojtjes, Z. Armend Mehaj dhe Ministrin e MAPL Z. Elbert Krasniqi, në mëngjesin e sotëm vizituan komunën e Klinës dhe Istogut, fillimisht vendet e prekura nga vërshimet, e më pas në QKMF-në e Istogut.



Fotografia 22. Kryeministri me Ministrin e Mbrojtjes në Komunën e Istogut

Njësitet specialiste të kërkim-shpëtimit të FSK-së kanë qenë në terren gjatë gjithë kohës për të ofruar mbështetjen e tyre. Angazhimi i FSK-së është në nivelin më të lartë dhe në bashkëpunim me autoritetet lokale dhe situata është duke u menaxhuar mirë. Niveli i ujit ka rënë edhe në këto dy qytete dhe gjendja është duke u normalizuar.



Fotografia 23. Takim me stafin e QKMF

Gjatë 24 orëve të fundit, FSK ka intervenuar në: Ferizaj, Mitrovicë, Skenderaj dhe Klinë, ku ndër të tjera është bërë edhe evakuimi i tri familjeve, kurse në Istog janë evakuuar 45 qytetarë.

Në këto pesë komuna janë angazhuar 58 ushtarë e gjithashtu në Babaj të Bokës është bërë edhe hapja e rrugës në gjatësi prej 100 metrash.

Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës janë në shërbim të plotë të qytetarëve.

5.3. MINISTRI I MBROJTJES Z. MEHAJ ME MINISTRIN E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL Z. KRASNIQI – VIZITË NË KOMUNËN E SKENDERAJIT

“Jemi vënë në shërbim të plotë të qytetarëve të Skenderajt me të gjitha kapacitetet tona që kemi në dispozicion. Ekipet tona gjenden në terren që nga dita e djeshme dhe do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim deri në kalimin e kësaj situatë jo të lehtë”, theksoi Ministri Mehaj me këtë rast, duke shtuar se autoriteteve lokale u janë ofruar mbështetje në zhblokimin e rrugëve, vendosjen e urave, evakuimin e banorëve, mbështetje me ushqim dhe barna.



Fotografia 24. Vizita në Skenderaj e Ministrit të Mbrojtjes

Gjithashtu, Ministri Mehaj dhe Ministri Krasniqi takuan edhe vullnetarë që kanë ndihmuar banorët për tejkalim e situatës, siç janë vullnetarët nga “Extreme off road Drenica”.

5.4. FORCA E SIGURISË SË KOSOVËS

Operacionet e FSK-së vazhduan edhe gjatë natës me ekipet e saj të Kërkim Shpëtimit në ujëra pas situatës së rënduar të përmytjeve në vend, ka ngritur gatishmërinë operacionale, duke marrë pjesë në operacionet e shpëtimit të jetëve të qytetarëve në zonat e prekura Skenderaj, Istog, Klinë dhe Mitrovicë.

Forca e Sigurisë së Kosovës është përgatitur dhe e gatshme që të mbështes autoritetet civile në përballje me situatën e krijuar nga vërshimet e ditëve të fundit.



Fotografia 25. FSK gjatë reagimit



Fotografia 26. Tërheqja e banorve nga zona vërshuese

6. ZYRA E KRYEMINISTRIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

6.1. VIZITA E KRYEMINISTRIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË KOMUNËN E SKENDERAJT

Me datë 22 Janar 2023 rreth orës 14:59, Kryeministri i Republikës së Kosovës Z. Albin Kurti ishte për vizitë në Komunën e Skenderajit (shih foto 27).



Fotografia 27. Vizita e Kryeministrit në Skenderaj



Fotografia 28. Vizita e Kryeministrit Mitrovicë

“Në Skënderaj dhe Mitrovicë isha sot bashkë me ministrat Mehaj e Krasniqi dhe zëvendësministrat Gashani e Dobra. Duke ju falenderuar angazhimit dhe solidaritetit të të gjithëve me njëri-tjetrin, nuk kemi jetë të humbura nga vërshimet. Ka dëme të konsiderueshme materiale, janë dëmtuar ndërtesa e infrastruktura publike, shtëpi banimi, ferma bujqësore e biznese”.



Fotografia 29. Vizita e Kryeministrit në terren në Komunën e Skenderajit



Në Skënderaj janë rrënuar dhe dëmtuar nëntë ura të vogla, kurse në Llaushë vizituam një fermer të cilit i janë mbytur mbi 10 mijë pula. Nëpër muret e ndërtesave kishte ngelur lart vija e gjurmës prej përmbytjes, ndërkaq brigjet e deformuara të lumenjve si dhe arat rrotull janë përplot mbeturina.



Fotografia 30. Vizita e Kryeministrit në terren në Komunën e Mitrovicës

Vërshimi në fshatin Lisicë të Mitrovicës, sipas banorëve, është pasojë e shtyrjes për afër 300 metra të rrjedhës së lumit Ibër si rezultat i ndërtimit të stadiumit në pjesën veriore të qytetit. Ibri e Sitnica janë bërë bashkë dhe janë shndërruar në liqe. Ka, jo pak kafshë të ngordhura, andaj edhe rreziku për epidemi ekziston. Pas takimeve me kryetarët e këtyre dy komunave, Fadil Nurën dhe Bedri Hamzën, vizituam bashkë disa vendbanime të përmytura.

Pjesëtarët e FSK-së e të policisë, zjarrfikësve dhe ndërmarrjeve publike u kanë shpërndarë ushqim, veshmbathje e batanije, barna e pako higjienike familjeve të evakuuara. Qeveria dhe komunat po punojnë bashkë në mbështetjen e qytetarëve për tejkalimin e kësaj situatë.

6.2. KOMISIONI QËNDROR PËR VLERËSIMIN E DËMEVE

Komisioni qëndror për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në të mirat material nga ndikimi i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera është emëruar në nivel vendi nga Kryeministri i Republikës së Kosovës.

Komisioni qëndror për vlerësimin e dëmeve, detyrat dhe përgjegjësit i ushtron, bazuar në Ligjin Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, Rregulloren 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësit Natyrore dhe Fatkeqësive tjera, si dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

AME/MPB luan rolin e Sekretarisë së Komisionit Qëndror për Vlerësimin e dëmeve, prandaj të gjitha komunat e Republikës së Kosovës duhet ti formojnë Komisionet për vlerësimin e dëmeve të cilat caktohen me vendim të Kryetarit të Komunës. Këto vlerësime do të hartohen bazuar në legjislacionin e lartë cekur.

Për të gjitha vështirësitë që hasin gjatë plotësimit të formularëve do të kenë mbështetjen e Sekretarisë së Komisionit Qëndror për Vlerësimin e dëmeve në AME.



7 MINISTRIA E ARSIMIT, SKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

Për shkak të reshjeve të mëdha në vend, të cilat kanë sjellë vërshime në disa komuna, është pamundësuar mbajtja e procesit mësimor në disa shkolla.

Zyrtarët e MASHTI të premtën, kanë qëndruar në disa shkolla për të parë nga afër gjendjen e krijuar për shkak të reshjeve, si dhe dëmet e shkaktuara në objekte shkollore.

Si Ministri jemi duke e përcjellë me kujdes të veçantë situatën dhe në kontakt të vazhdueshën me institucionet përgjegjëse për menaxhimin e situatave emergjente si dhe drejtorët e DKA-ve, ndërsa do të ju informojmë me kohë për ditën e hënë si dhe me drejtorët e DKA-së, për t'u informuar në detaje për çdo zhvillim në komunën e tyre.

Bazuar në të dhënat e MASHTI komunat të cilat nuk kanë mbajtur mësim sot, shkak i dëmtimit të shkollave nga rreshjet e shiut, janë:

1. Podujevë: Mësimi nuk është zhvilluar në fshatin Pakashticë dhe në fshatin Peran;
2. Viti: Në katër fshatra të Vitisë ka dëme të çatave në shkolla, mirëpo mësimi është duke u mbajtur;
3. Mitrovicë: Mësimi nuk është mbajtur në asnjë shkollë, si arsye e dëmeve dhe vërshimeve që janë krijuar nga të reshurat;
4. Skënderaj: Mësimi nuk është mbajtur në asnjë shkollë, si arsye e dëmeve dhe vërshimeve që janë krijuar nga të reshurat;
5. Pejë: Mësimi nuk është mbajtur në fshatin Kliqinë, ndërsa në fshatrat tjera deri më tash nuk ka probleme;
6. Istog: Mësimi nuk është mbajtur në shkollën "Avni Rrustemi", kurse dëme të mëdha ka edhe në shkollat tjera, por mësimi është zhvilluar;
7. Klinë: Mësimi nuk është mbajtur në asnjë shkollë të kësaj komune, si arsye e dëmeve dhe vërshimeve që janë krijuar nga të reshurat;
8. Zubin Potok: Mësimi nuk është duke u mbajtur në asnjë shkollë, si arsye e dëmeve.

Ndërkaq, komunat të cilat kanë raportuar që nuk kanë dëme dhe mësimi është mbajtur në të gjitha shkollat janë: Prishtinë, Fushë Kosovë, Drenas, Ferizaj, Shtime, Lipjan, Hani i Elezit, Kaçanik, Gjakovë, Rahovec, Malishevë, Gjilan, Kamenicë, Novobërdë, Vushtrri, Deçan, Prizren, Suharekë, Junik, Dragash, Mamushë, Leposaviq, Zveçan.

8 MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Me datë 20.01.2023 Zv. Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Imri Demelezi, gjatë ditës së sotme vizitoi qytetarët e komunës së Skënderajt dhe asaj të Klinës, komuna të cilat kanë pësuar dëme të konsiderueshme nga vërshimet e fundit.

Zëvendësministri Demelezi e pa nga afër gjendjen e rënduar dhe tha se qeveria është e përkushtuar që të ofroj mbështetje për secilin qytetar nga secila komunë.



Fotografia 31. Vizita në Klinë



Fotografia 32. Vizita në Klinë

Me datë 24.01.2023, Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Faton Peci, realizoi vizitë në komunën e Mitrovicës, Zubin Potokut, komunën e Skënderajt, atë të Klinës, si dhe komunën e Istogut për të parë nga afër dëmet shkaktuara nga vërshimet të cilat ishin të konsiderueshme në këto zona të vendit.



Fotografia 33. Vizita në Klinë

Ministri i BPZhr-së Faton Peci me këtë rast vizitoi bujqit të cilët janë prekur nga këto vërshime dhe njëkohësisht inkurajoi që t'i dokumentojnë dëmet e shkaktuara dhe të njëjtat t'i dorëzojnë pranë Drejtorive për Bujqësi. “Bashkëndjeva me qytetarët e prekur nga vërshimet, fatkeqësisht në Mitrovicë, Çabër, Skenderajt, Klinë dhe Istog; si dhe i sigurova ata se asnjë dëm nuk do anashkalohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës”, shtoi ndër tjera Ministri Peci.

Përpos inspektimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore tek bujqit, Ministri Peci zhvilloi takime me kryetarët e komunave, si: atë të Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, të Komunës së Skenderajt, Fadil Nura, si dhe me Kryetarin e Komunës së Istogut, Ilir Ferati të cilët e njoftuan Ministrin Peci në detaje për situatën sfiduese me të cilën po përballen komunat respektive.

Gjithashtu, Ministri i Bujqësisë Faton Peci theksoi se nga ky vit, Komisioni i Dëmeve në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, do t'i trajtojë të gjitha dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore përfshirë edhe dëmet në sektorin e bujqësisë



Fotografia 34. Vizita në Klinë



Fotografia 35. Vizita në Skenderaj



Fotografia 36. Vizita në Istog



Fotografia 37. Vizita në Istog



9 INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETIT PUBLIK I KOSOVËS

9.1. REKOMANDIMET PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT IKSHP/QRSHP

Monitorim i vazhdueshëm në lidhje me situatën e krijuar pas reshjeve të shiut me datë 19.01.2023 ora 06:52.



Fotografia 38. Uji i pijshëm

Situata aktuale me ujë të pijes në zonat e vërsuara 19.01.2023 ora 08:00

Aktualisht, si rezultat i reshjeve të shtuara ditëve të fundit, prurjeve të mëdha nga zonat fushore dhe shkarkim i ujërave drenuese, në shumicën e resurse ujore si pasojë është vërejtur ngritje e vlerave të turbullirës.

Vlera të shtuara të turbullirës, më shumë se 100 NT, janë regjistruar në disa burime dhe si pasojë ka vështirësi në trajtim të ujit në zonat:

- KRU "Prishtina"- Rajoni Prishtinë: fabrika në Shkabaj dhe fabrika në Drenas;
 - KRU "Mitrovica"- Rajoni Mitrovicë: fabrika në Shipol- Mitrovicë dhe fabrika në Balice- Vushtrrisë;
 - KRU "Hidrodrini"- Rajoni i Pejës: burimi Drini I Bardhe –Radavc dhe burimi Shkoze -Junik;
 - KRU "Gjakovë"- Rajoni i Gjakovës: burimi në Demjan dhe Gërqinë;
 - KRU "Bifurkacioni"- Rajoni Ferizaj: fabrika në Pleshinë dhe sistemi në Kaçanik;
 - Në mostrat e grumbulluara deri sot nga rajonet me të reshura të shtuara, analiza laboratorike fiziko-kimike, rezultojnë me vlerë të ngritur të turbullirës e cila i tejkalon vlerat standarde të lejuara;
 - Mostrat për ekzaminim bakteriologjik deri më sot rezultojnë brenda standardeve të parapara.
- Uji në rrjetet shpërndarëse nga këto sisteme për shkak të vlerave të shtuara të turbullirës nuk është brenda standardit të paraparë.

Rekomandohen konsumatorët që uji para përdorimit të vlohet si masë e sigurisë bakteriologjike e zbatueshme në situata me turbullirë të shtuar në resurse. Ekipet tona në teren vazhdojnë me monitorim të rregullt.

Jemi në kontakt dhe bashkëveprim të vazhdueshëm me personelin përgjegjës në KRU-të deri në stabilizimin e plotë të gjendjes.



Situata aktuale me ujë të pijes në zonat e vërshuara- datë 20.01.2023 ora 14:00

Ekipet e Institutit Kombëtar kanë ngritur vigjilencën dhe monitorimin e ujit për pije. Janë regjistruar vlera të shtuara të turbullirës në disa burime dhe si pasojë ka vështirësi në trajtim të ujit në zonat :

KRU "Prishtina"- Rajoni Prishtinë: fabrika në Shkabaj dhe fabrika në Drenas.

Turbullira e shtuar në Kanalin Ibër- Lepenc e ka vështërsu procesin e trajtimit të ujit në FPU Shkabaj dhe në FPU Drenas. Këto dy fabrika janë jashtë funksionit për shkak të pamundësisë të proceseve teknologjike të përpunimit të ujit. Për shkak të uljes së kapacitetit prodhues janë duke u zbatuar restriksione në tërë zonat e shërbimit të KRU-Prishtina.

Të gjitha mostrat e testuara në laboratorët e IKSHPK janë brenda standardeve për ujë të pijshëm sipas Udhëzimit Administrativ Nr.10/21 për cilësi dhe konsum human.

KRU "Mitrovica"- Rajoni Mitrovicë: fabrika në Shipolit- Mitrovicë dhe fabrika në Balice- Vushtrrisë.

Nga dje, datë 19.01.2023 FPU Balicë/Vushtri dhe FPU ne Shipol/Mitrovicë ka ndërpre furnizimin me ujë në Mitrovicë dhe Skenderajt për shkak të rritjes së turbullirës në ujin e pa përpunuar.

Pritet në orët e pasdites të startoj trajtimi me kapacitet të zvogëluar.

Në mostrat e grumbulluara deri dje, analiza laboratorike fiziko-kimike rezultojnë me vlerë të ngritur të turbullirës e cila i tejkalon vlerat standarde të lejuara. Nga rezultatet preliminare të mostrave akteriologjike të ditës së djeshme, janë në rimbledhje dhe rezultatet përfundimtare dhe do të përfundojnë nesër.

KRU "Hidrodrini"- Rajoni i Pejës: burimin Drini I Bardhë –Radavc dhe burimi Shkozë-Junik. Turbullira vazhdon me qenë prezente në burimet Drini i Bardhe-Radavc dhe Shkozë-Junik.

Ndërsa për shkak të vërshimeve dhe prurjeve në burime është ndërprerë furnizimi me ujë nga burimi Jarine-Klinë dhe tani furnizimi bëhet vetëm nga fabrika e ujit në Klinë. Gjithashtu është ndërprerë furnizimi me ujë nga burimi i ujit - drenazhet sistemi CDF-Deçan.

Të gjitha mostrat e testuara në laboratorët e QRSH-Deçan janë brenda standardeve për ujë të pijshëm sipas Udhëzimit Administrativ Nr.10/21 për cilësi dhe konsum human.

KRU "Gjakovë"- Rajoni i Gjakovës: burimi në Demjan dhe Gërqinë.

Në zonat e furnizimit nga KRU "Gjakova" gjendja e cilësisë së ujit të pijes është në rregull, të gjitha mostrat e analizuar janë brenda standardeve të parapara për ujin e pijshëm.

Në zonat e furnizimit nga burimet në Demjan dhe Gërqinë uji nuk është për pije për shkak të vlerave të shtuara të turbullirës.

KRU "Bifurkacioni"- Rajoni Ferizaj: fabrika në Pleshinë dhe sistemi në Kacanik- të gjitha mostrat e ujit të cilat janë marrë dje dhe sot në Ferizaj dhe Kaçanik janë brenda standardeve për ujin e pijes.

Uji në rrjetet shpërndarëse nga sistemi i ujësjellësit është me vlera të shtuara të turbullirës, që kalon nivelin standart të paraparë dhe nuk rekomandohet të pihet.

-Rekomandohen konsumatorët që uji para përdorimit të vlohet si masë e sigurisë bakteriologjike e zbatueshme në situata me turbullirë të shtuar në resurse Ekipet tona në teren vazhdojnë me monitorim të rregullt.



Situata aktuale me ujë të pijes në vendbanimet e vërsuara me datë 20.01.2023 ora 18:00

Ju lutemi për kujdes të shtuar!

Mos e përdorni ujin e ujësjellësit të pa vluar! Uji para përdorimit patjetër të vlohet si masë e sigurisë bakteriologjike, e zbatueshme në situata me turbullirë të shtuar në resurse ujore për të parandaluar shpërthimin e epidemive hidrike. Kjo procedurë e vlimit të ujit është aq e thjeshtë dhe e zakonshme, por e domosdoshme për të parandaluar shpërthime epidemike. -Të shfrytëzohen resurset e sigurta ose uji i ambalazhuar. Si pasojë e vërsimeve në pjesën më të madhe të vendit tonë situata me ujë të pijes është vështërsuar dukshëm.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka ngritur nivelin e gatishmërisë me të gjitha institucionet përkatëse. Ekipe të Institutit Kombëtar kanë ngritur vigjilencën dhe monitorimin e ujit për pije.

Të gjitha QRSHP në Kosovë janë në gjendje gatishmërie me ekipe kujdestare pa ndërprerë me specialistët e ekologjisë humane dhe epidemiologjisë dhe po monitorojnë situatën epidemiologjike.

Duke pasur parasysh se janë regjistruar vlera të shtuara të turbullirës në shumë burime, si pasojë ka vështirësi në trajtim të ujit në zonat:

KRU "Prishtina"- Rajoni Prishtinë: fabrika në Shkabaj dhe fabrika në Drenas.

Turbullira e shtuar në Kanalin Ibër -Lepenc e ka vështërsuar procesin e trajtimit të ujit në FPU Shkabaj dhe në FPU Drenas. Këto dy fabrika janë jashtë funksionit për shkak të pamundësisë të proceseve teknologjike të përpunimit të ujit. Për shkak të uljes së kapacitetit prodhues janë duke u zbatuar restriksione në tërë zonat e shërbimit të KRU-Prishtina. Të gjitha mostrat e testuara në laboratorët e IKSHPK janë brenda standardeve për ujë të pijshëm sipas Udhëzimit Administrativ Nr.10/21 për cilësi dhe konsum human.

KRU "Mitrovica"- Rajoni Mitrovicë: fabrika e Shipolit- Mitrovicë dhe fabrika e Balicës- Vushtrri.

Nga dje, datë 19.01.2023 FPU Balicë/Vushtri dhe FPU Shipol/Mitrovicë ka ndërpre furnizimin në Mitrovicë dhe Skënderaj për shkak të rritjes së turbullirës në ujin e pa përpunuar.

-Pritet në orët e pasdites të startoj trajtimi me kapacitet të zvogluar. Në mostrat e grumbulluara deri dje, analiza laboratorike fiziko-kimike rezultojnë me vlerë të ngritur të turbullirës e cila i tejkalon vlerat standarde të lejuara. Nga rezultatet preliminare të mostrave bakteriologjike të ditës së djeshme, janë në rimbledhje dhe rezultatet përfundimtare do të përfundojnë nesër.

-KRU "Hidrodrini"- Rajoni i Pejës: burimi Drini i Bardhë –Radavc dhe burimi Shkozë- Junik.

Turbullira vazhdon me qenë prezente në burimet Drini i Bardhe-Radavc dhe Shkozë-Junik.

Ndërsa për shkak të vërsimeve dhe prurjeve në burime është ndërprerë furnizimi me ujë nga burimi Jarine - Klinë dhe tani furnizimi bëhet vetëm nga fabrika e ujit në Klinë. Gjithashtu është ndërprerë furnizimi me ujë nga burimi i ujit - drenazha CDF-Deçan.

Të gjitha mostrat e testuara në laboratorët e QRSHP - Pejë janë brenda standardeve për ujë të pijshëm sipas Udhëzimit Administrativ Nr.10/21 për cilësi dhe konsum human.

KRU "Gjakovë"- Rajoni i Gjakovës: burimi në Demjan dhe Gërqinë.

Në zonat e furnizimit nga KRU "Gjakova" gjendja e cilësisë së ujit të pijes është në rregull, të gjitha mostrat e analizuara janë brenda standardeve të parapara për ujin e pijshëm.

Në zonat e furnizimit nga burimet në Demjan dhe Gërqinë, uji nuk është për pije për shkak të vlerave të shtuara të turbullirës.

KRU "Bifurkacioni"- Rajoni Ferizaj: fabrika në Pleshinë dhe sistemi në Kaçanik.

Te gjitha mostrat e ujit të cilat janë marrë dje dhe sot në Ferizaj dhe Kaçanik janë brenda standardeve për ujë të pijes.



IKSHP/Qendra e ujit rekomandon dhe apelon qytetarët që:

Uji para përdorimit patjetër të vlohet si masë e sigurisë bakteriologjike, e zbatueshme në situata me turbullirë të shtuar në ujë për të parandaluar shpërthimin e epidemive hidrike. Kjo procedure e vlimit të ujit është aq e thjeshtë dhe e zakonshme, por e domosdoshme për të parandaluar shpërthime epidemike.

Të shfrytëzohen resurset e sigurta ose uji i ambalazhuar.

-IKSHPK / Qendra e Ujit rekomandon të gjitha Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit (KRU) me qëllim të stabilizimit të furnizimit: -përdorimi/shfrytëzim i burimeve të paprekura;

-Furnizimi me autobote/cisterna me ujë të pijshëm;

-Riparimi dhe zhblokimi i pusetave;

-Riparimi i dëmtimeve në rrjetin shpërndarës;

-Kujdes i shtuar në procesin e trajtimit dhe dezinfektimit;

Bashkëveprimi i IKShPK/QU dhe KRU-ve me institucionet shtetërore është në kontinuitet deri në qetësimin e situatës;

Ekipet e Institutit Kombëtar janë në gjendje gatishmërie dhe vazhdojnë me monitorim të rregullt dhe në dispozicion me të gjitha kapacitetet për të ruajtur situatën stabile dhe për çdo përqendrim të situatës epidemiologjike do të informoheni në kohë reale.

Situata aktuale me ujë të pijes në vendbanimet e vërshuara me datë 20.01.2023 ora 12:00

Ju lutemi për kujdes të shtuar!

Si pasojë e vërshimeve në pjesën më të madhe të vendit tonë situata me ujë të pijes është vështërsuar dukshëm.

-Qeveria e Republikës së Kosovës ka ngritur nivelin e gatishmërisë me të gjitha institucionet përkatëse.

Ekipet e Institutit Kombëtar kanë ngritur vigjilencën dhe janë në monitorim të pandërprerë të ujit të pijes.

-Të gjitha QRSHP në Kosovë janë në gjendje gatishmërie me ekipe kujdestare pa ndërprerë me specialistët e ekologjisë humane dhe epidemiologjisë dhe po monitorojnë situatën epidemiologjike e cila është në kontroll dhe nuk ka raste të dyshimta të sëmundjeve ngjitëse si pasojë e vërshimeve.

-Duke pasur parasysh se janë regjistruar vlera të shtuara të turbullirës në shumë burime, si pasojë ka vështirësi në trajtim të ujit në zonat me të dhënat e përditësuara (21 Janar 2023):

-KRU "Prishtina"- Rajoni Prishtinë: fabrika në Shkabaj dhe fabrika në Drenas.

-Dy fabrikat janë jashtë funksionit për shkak të pamundësisë të proceseve teknologjike të përpunimit të ujit. Për shkak të uljes së kapacitetit prodhues janë duke u zbatuar restriksione në tërë zonat e shërbimit të KRU-Prishtina.

-Të gjitha mostrat e testuara në laboratorët e IKShPK janë brenda standardeve për ujë të pijshëm sipas Udhëzimit Administrativ Nr.10/21 për cilësi dhe konsum human.

-KRU "Mitrovica"- Rajoni Mitrovicë: Fabrikat në Shipol- Mitrovicë dhe në Balicë- Vushtrrisë kanë startuar trajtimin e ujit me kapacitet të zvogluar.

-Në mostrat e grumbulluara, analizat laboratorike fiziko-kimike dhe bakteriologjike rezultojnë se uji nuk është brenda standardeve, andaj rekomandohet që uji para përdorimit të vlohet. Për shkak të vërshimeve uji i puseve nuk është i sigurt dhe duhet patjetër të vlohet para përdorimit.

-KRU "Hidrodrini"- Rajoni i Pejës: burimin Drini i Bardhë –Radavc dhe burimi Shkozë- Junik.

Turbullira vazhdon me qenë prezente në burimet Drini i Bardhë-Radavc dhe Shkozë-Junik.

Ndërsa për shkak të vërshimeve dhe prurjeve në burime është ndërprerë furnizimi me ujë nga burimi Jarine - Klinë dhe tani furnizimi bëhet vetëm nga fabrika e ujit në Klinë.



Të gjitha mostrat e testuara në laboratorët e QRSHP - Pejë janë brenda standardeve për ujë të pijshëm sipas Udhëzimit Administrativ Nr.10/21 për cilësi dhe konsum human.

-KRU "Gjakovë"- Rajoni i Gjakovës: burimi në Demjan, Gërqinë dhe Rekë.

Në zonat e furnizimit nga KRU "Gjakova" gjendja e cilësisë së ujit të pijes është e qetë, të gjitha mostrat e analizuar janë brenda standardeve të parapara për ujin e pijshëm.

Në zonat e furnizimit nga burimet në Demjan, Gërqinë dhe Rekë uji nuk është për pije për shkak të vlerave të shtuara të turbullirës.

-KRU "Bifurkacioni"- Rajoni Ferizaj: fabrika në Pleshinë dhe sistemi në Kaçanik.

Te gjitha mostrat e ujit të cilat janë marrë dje dhe sot në Ferizaj dhe Kaçanik janë brenda standardeve për ujin e pijes.

-Uji në rrjetet shpërndarëse është normalizuar dhe është brenda standardeve të parapara për ujë të pijshëm.

-IKSHPK/Qendra e ujit rekomandon dhe apelon qytetarët që:

-Uji para përdorimit patjetër të vlohet si masë e sigurisë bakteriologjike, e zbatueshme në situata me turbullirë të shtuar në resurse për të parandaluar shpërthimin e epidemive hidrike. Kjo procedure e vlimit të ujit është aq e thjeshtë dhe e zakonshme, por e domosdoshme për të parandaluar shpërthime epidemike.

Të shfrytëzohen resurset e sigurta ose uji i ambalazhuar.

-IKSHPK / Qendra e Ujit rekomandon të gjitha Kompanitë Rajonale të Ujësjesit (KRU) me qëllim të stabilizimit të furnizimit:

- Përcjellja e vlerave të turbullirës dhe kujdes i shtuar në procesin e trajtimit;
- Kujdes i shtuar në procesin e dezinfektimit;
- Mbrojtje të stabilimenteve dhe të burimeve;
- Sanimin e gjendjes aktuale në rast të defekteve teknike;
- Riparimi dhe deblokimi i pusetave;
- Sanimi i demtimeve në rrjetin shpërndarës.

Bashkëveprimi i IKShPK/QU dhe KRU-ve me institucionet shtetërore është në kontinuitet deri në qetësimin e situatës.

-Ekipet e Institutit Kombëtar janë në gjendje gatishmërie dhe vazhdojnë me monitorim të rregullt dhe në dispozicion me të gjitha kapacitetet për të ruajtur situatën stabile dhe për çdo përkeqësim të situates epidemiologjike do të informoheni në kohë reale.

Situata aktuale me ujë të pijes në zonat e vërsuara me datë 21.01. 2023 ora 15:00

Ju lutemi për kujdes të shtuar!

-Uji para përdorimit patjetër të vlohet si masë e sigurisë bakteriologjike, e zbatueshme në situata me turbullirë të shtuar në resurse, për të parandaluar shpërthimin e epidemive hidrike. Kjo procedurë e vlimit të ujit është aq e thjeshtë dhe e zakonshme, por e domosdoshme për të parandaluar shpërthime epidemike.

-Të shfrytëzohen resurset e sigurta ose uji i ambalazhuar.

Si pasojë e vërsimeve në pjesën më të madhe të vendit tonë situata me ujë të pijes është vështërsuar dukshëm.

-Qeveria e Republikës së Kosovës ka ngritur nivelin e gatishmërisë me të gjitha institucionet përkatëse.



Ekipe të Institutit Kombëtar po vazhdojnë me vigjilencë të shtuar dhe janë në monitorim të pandërprerë të ujit të pijes.

Të gjitha QRSHP në Kosovë janë në gjendje gatishmërie me ekipe kujdestare pa ndërprerë me specialistët e ekologjisë humane dhe epidemiologjisë dhe po monitorojnë situatën epidemiologjike e cila është në kontroll dhe nuk ka raste të dyshimta të sëmundjeve ngjitëse si pasojë e vërshimeve.

-Duke pasur parasysh se janë regjistruar vlera të shtuara të turbullirës në shumë burime, si pasojë ka vështirësi në trajtim të ujit në zonat me të dhënat e përditësuara (23 Janar 2023):

KRU "Prishtina"- Rajoni Prishtinë: Fabrika në Shkabaj mbetet jashtë funksionit.

Fabrika në Drenas ka startuar mbrëmë me trajtimin e ujit me kapacitet të zvogëluar. Për shkak të uljes së kapacitetit prodhues janë duke u zbatuar restriksione në tërë zonat e shërbimit të KRU-Prishtina.

Të gjitha mostrat e testuara në laboratorët e IKSHPK janë brenda standardeve për ujë të pijshëm sipas Udhëzimit Administrativ Nr.10/21 për cilësi dhe konsum human.

Klori rezidual në rrjetin shpërndarës është 0,2mg-0,3mg/L.

Rekomandohet që uji para përdorimit të vlohet.

KRU "Mitrovica"- Rajoni Mitrovicë: Fabrikat në Shipol- Mitrovicë dhe në Balicë- Vushtrrisë janë në funksion të plotë me trajtimin e ujit.

Në mostrat e grumbulluara, analizat laboratorike fiziko-kimike dhe bakteriologjike rezultojnë se uji nuk është brenda standardeve, andaj rekomandohet që uji para përdorimit të vlohet. Klori rezidual në rrjetin shpërndarës është 0,2mg-0,3mg/L në Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj.

Për shkak të vërshimeve uji i puseve nuk është i sigurt dhe duhet patjetër të vlohet para përdorimit.

KRU "Hidrodrini"- Rajoni i Pejës: burimin Drini i Bardhë –Radavc dhe burimi Shkozë, Junik.

Turbullira vazhdon me qenë prezente në burimet Burimi Drini i Bardhë-Radavc dhe burimi Shkozë-Junik.

Ndërsa për shkak të vërshimeve dhe prurjeve në burime, është ndërprerë furnizimi me ujë nga burimi Jarinë - Klinë dhe tani furnizimi bëhet vetëm nga fabrika e ujit në Klinë.

Burimi i Istogut paraqitet akoma me turbullirë, nuk rekomandohet për pije dhe para përdorimit duhet të vlohet.

Të gjitha mostrat e testuara në laboratorët e QRSHP - Pejë janë brenda standardeve për ujë të pijshëm sipas Udhëzimit Administrativ Nr.10/21 për cilësi dhe konsum human.

Klori rezidual në rrjetin shpërndarës është 0.1mg-0,3mg/L.

KRU "Gjakovë"- Rajoni i Gjakovës:

Në zonat e furnizimit nga KRU "Gjakova" gjendja e cilësisë së ujit të pijes është rregull, pos sistemi i Gërqinës, i cili ka akoma turbullirë të shtuar, andaj uji nuk rekomandohet për pije dhe para përdorimit duhet të vlohet.

Të gjitha mostrat e analizuara janë brenda standardeve të parapara për ujin e pijshëm.

Klori rezidual në rrjetin shpërndarës është 0,3mg-0,35mg/L.

KRU "Bifurkacioni"- Rajoni Ferizaj: fabrika në Pleshinë dhe sistemi në Kaçanik.

Të gjitha mostrat e ujit të cilat janë marrë në Ferizaj janë brenda standardeve për ujin e pijes.

Klori rezidual në rrjetin shpërndarës është 0,2mg-0,3mg/L.



Në ujësjellësin e Kaçanikut, Hanit të Elezit dhe Shtërpçës, mostrat e ujit nuk përmbushin standardin.

Klori rezidual në rrjetin shpërndarës është 0,02mg/L.

Rekomandohet që uji para përdorimit të vlohet.

KRU "Hidromorava"- Rajoni Gjilan:

Të gjitha mostrat e ujit të cilat janë marrë në Gjilan janë brenda standardeve për ujin e pijes.

Klori rezidual në rrjetin shpërndarës është 0,1mg-0,2mg/L.

Për shkak të shtimit të turbullirës, fabrika në Letnicë-Viti ka ndërprerë furnizimin me ujë të pijes.

IKSHPK/Qendra e ujit rekomandon dhe apelon qytetarët që:

-Uji para përdorimit patjetër të vlohet si masë e sigurisë bakteriologjike, e zbatueshme në situata me turbullirë të shtuar në resurse ujore, për të parandaluar shpërthimin e epidemive hidrike. Kjo procedure e vlimit të ujit është aq e thjeshtë dhe e zakonshme, por e domosdoshme për të parandaluar shpërthime epidemike.

Të shfrytëzohen resurset e sigurta ose uji i ambalazhuar.

-IKSHPK / Qendra e Ujit rekomandon të gjitha Kompanitë Rajonale të Ujësjetës (KRU) me qëllim të stabilizimit të furnizimit:

- Përcjellja e vlerave të turbullirës dhe kujdes i shtuar në procesin e trajtimit
- Kujdes i shtuar në procesin e dezinfektimit
- Mbrojtje të stabilimenteve dhe të burimeve
- Sanimin e gjendjes aktuale në rast të defekteve teknike
- Riparimi dhe deblokimi i pusetave
- Sanimi i dëmtimeve në rrjetin shpërndarës

Bashkëveprimi i IKShPK/QU dhe KRU-ve me institucionet shtetërore është në kontinuitet deri në qetësimin e situatës.

-Ekipet e Institutit Kombëtar janë në gjendje gatishmërie dhe vazhdojnë me monitorim të rregullt dhe në dispozicion me të gjitha kapacitetet për të ruajtur situatën stabile dhe për çdo përkeqësim të situatës epidemiologjike do të informoheni në kohë reale.

-Bashkëveprimi i IKShPK/QU dhe KRU-ve me institucionet shtetërore është në kontinuitet deri në qetësimin e situatës.

-Ekipet e Institutit Kombëtar janë në gjendje gatishmërie dhe vazhdojnë me monitorim të rregullt dhe në dispozicion me të gjitha kapacitetet për të ruajtur situatën stabile dhe për çdo përkeqësim të situatës epidemiologjike do të informoheni në kohë reale.



Fotografia 39. Uji i pijes

Situata aktuale me ujë të pijes në zonat e vërshuara me datë 24.01.2023 ora 08:00

Ju lutemi për kujdes të shtuar!

-Uji para përdorimit patjetër të vlohet si masë e sigurisë bakteriologjike, e zbatueshme në situata me turbullirë të shtuar në resurse, për të parandaluar shpërthimin e epidemive hidrike. Kjo procedurë e vlimit të ujit është aq e thjeshtë dhe e zakonshme, por e domosdoshme për të parandaluar shpërthime epidemike.

-Të shfrytëzohen resurset e sigurta ose uji i ambalazhuar.

-Si pasojë e vërshimeve në pjesën më të madhe të vendit tonë situata me ujë të pijes është vështërsuar dukshëm.

-Qeveria e Republikës së Kosovës ka ngritur nivelin e gatishmërisë me të gjitha institucionet përkatëse.

Ekipet e Institutit Kombëtar po vazhdojnë me vigjilencë të shtuar dhe janë në monitorim të pandërprerë të ujit të pijes.

Të gjitha QRSHP në Kosovë janë në gjendje gatishmërie me ekipe kujdestare pa ndërprerë me specialistët e ekologjisë humane dhe epidemiologjisë dhe po monitorojnë situatën epidemiologjike e cila është në kontroll dhe nuk ka raste të dyshimta të sëmundjeve ngjitëse si pasojë e vërshimeve.

-Duke pasur parasysh se janë regjistruar vlera të shtuara të turbullirës në shumë burime, si pasojë ka vështirësi në trajtim të ujit në zonat me të dhënat e përditësuara (24 Janar 2023):

KRU "Prishtina"- Rajoni Prishtinë: Fabrika në Shkabaj mbetet jashtë funksionit.

Fabrika në Drenas ka ndërprerë trajtimin e ujit për shkak të turbullirës.

Për shkak të uljes së kapacitetit prodhues janë duke u zbatuar restriksione në tërë zonat e shërbimit të KRU-Prishtina.



Të gjitha mostrat e testuara në laboratorët e IKSHPK janë brenda standardeve për ujë të pijshëm sipas Udhëzimit Administrativ Nr.10/21 për cilësi dhe konsum human.

Klori rezidual në rrjetin shpërndarës është 0,2mg-0,3mg/L.

Rekomandohet që uji para përdorimit të vlohet.

KRU "Mitrovica"- Rajoni Mitrovicë: Fabrikat në Shipol- Mitrovicë dhe në Balicë- Vushtrrisë janë në funksion të plotë me trajtimin e ujit.

Në mostrat e grumbulluara, analizat laboratorike fiziko-kimike dhe bakteriologjike rezultojnë brenda standardeve.

Klori rezidual në rrjetin shpërndarës është 0,3mg-0,5mg/L në Mitrovicë, Vushtrri.

Në Skenderaj mostrat e ujit nuk i përgjigjen standardeve të ujit të pijshëm.

Rekomandohet që uji patjetër të vlohet para përdorimit.

Për shkak të vërshimeve, uji i puseve nuk është i sigurt dhe duhet patjetër të vlohet para përdorimit.

KRU "Hidrodrini"- Rajoni i Pejës: burimin Drini i Bardhë –Radavc dhe burimi Shkozë, Junik.

Turbullira vazhdon me qenë prezente në burimet Drini i Bardhë-Radavc dhe Shkozë-Junik.

Rekomandohet që uji patjetër të vlohet para përdorimit.

Ndërsa për shkak të vërshimeve dhe prurjeve në burime, është ndërprerë furnizimi me ujë nga burimi Jarinë - Klinë dhe tani furnizimi bëhet vetëm nga fabrika e ujit në Klinë. Mostrat e ujit nuk i përgjigjen standardeve të ujit të pijshëm. Rekomandohet që uji patjetër të vlohet para përdorimit.

Burimi i Istogut paraqitet akoma me turbullirë, nuk rekomandohet për pije dhe para përdorimit duhet të vlohet.

Të gjitha mostrat e testuara në laboratorët e QRSHP - Pejë janë brenda standardeve për ujë të pijshëm sipas Udhëzimit Administrativ Nr.10/21 për cilësi dhe konsum human.

Klori rezidual në rrjetin shpërndarës është 0.1mg-0,3mg/L.

KRU "Gjakovë"- Rajoni i Gjakovës:

Në zonat e furnizimit nga KRU "Gjakova" gjendja e cilësisë së ujit të pijes është në rregull. Të gjitha mostrat e analizuara janë brenda standardeve të parapara për ujin e pijshëm.

Klori rezidual në rrjetin shpërndarës është 0,3mg-0,35mg/L.

KRU "Bifurkacioni"- Rajoni Ferizaj: fabrika në Pleshinë dhe sistemi në Kaçanik.

Të gjitha mostrat e ujit të cilat janë marrë në Ferizaj dhe Kaçanik janë brenda standardeve për ujin e pijes.

Klori rezidual në rrjetin shpërndarës është 0,2mg-0,3mg/L.



Në ujësjellësin e Hanit të Elezit dhe Shtërpçës, mostrat e ujit nuk përmbushin standardin.

Klori rezidual në rrjetin shpërndarës është 0,02mg/L.

Rekomandohet që uji para përdorimit të vlohet.

KRU "Hidromorava"- Rajoni Gjilan:

Të gjitha mostrat e ujit të cilat janë marrë në Gjilan janë brenda standardeve për ujin e pijes.

Klori rezidual në rrjetin shpërndarës është 0,1mg-0,2mg/L.

Për shkak të shtimit të turbullirës, fabrika në Letnicë-Viti ka ndërprerë furnizimin me ujë të pijes dhe ende është jashtë funksionit.

Rekomandohet që uji patjetër të vlohet para përdorimit.

-IKSHPK/Qendra e ujit për pije rekomandon dhe apelon qytetarët që:

-Uji para përdorimit patjetër të vlohet si masë e sigurisë bakteriologjike, e zbatueshme në situata me turbullirë të shtuar në resurse ujore për të parandaluar shpërthimin e epidemive hidrike. Kjo procedure e vlimit të ujit është aq e thjeshtë dhe e zakonshme, por e domosdoshme për të parandaluar shpërthime epidemike.

Të shfrytëzohen resurset e sigurta ose uji i ambalazhuar.

-IKSHPK / Qendra e Ujit për pije , rekomandon të gjitha Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit (KRU) me qëllim të stabilizimit të furnizimit:

- Përcjellja e vlerave të turbullirës dhe kujdes i shtuar në procesin e trajtimit
- Kujdes i shtuar në procesin e dezinfektimit
- Mbrojtje të stabilimenteve dhe të burimeve
- Sanimin e gjendjes aktuale në rast të defekteve teknike
- Riparimi dhe deblokimi i pusetave
- Sanimi i dëmtimeve në rrjetin shpërndarës

Bashkëveprimi i IKShPK/QU dhe KRU-ve me institucionet shtetërore është në kontinuitet deri në qetësimin e situatës.

-Ekipet e Institutit Kombëtar janë në gjendje gatishmërie dhe vazhdojnë me monitorim të rregullt dhe në dispozicion me të gjitha kapacitetet për të ruajtur situatën stabile dhe për çdo përkeqësim të situatës epidemiologjike do të informoheni në kohë reale.



Situata aktuale me ujë të pijes në zonat e vërsuara me datë 24.01.2023 ora 15:00

Ju lutemi për kujdes të shtuar!

-Uji para përdorimit patjetër të vlohet si masë e sigurisë bakteriologjike, e zbatueshme në situata me turbullirë të shtuar në resurse ujore për të parandaluar shpërthimin e epidemive hidrike. Kjo procedurë e vlimit të ujit është aq e thjeshtë dhe e zakonshme, por e domosdoshme për të parandaluar shpërthime epidemike.

-Të shfrytëzohen resurset e sigurta ose uji i ambalazhuar.

Si pasojë e vërsimeve në pjesën më të madhe të vendit tonë situata me ujë të pijes është vështërsuar dukshëm.

-Qeveria e Republikës së Kosovës ka ngritur nivelin e gatishmërisë me të gjitha institucionet përkatëse.

Ekipet e Institutit Kombëtar po vazhdojnë me vigjilencë të shtuar dhe janë në monitorim të pandërprerë të ujit të pijes.

Të gjitha QRSHP në Kosovë janë në gjendje gatishmërie me ekipe kujdestare pa ndërprerë me specialistët e ekologjisë humane dhe epidemiologjisë dhe po monitorojnë situatën epidemiologjike e cila është në kontroll dhe nuk ka raste të dyshimta të sëmundjeve ngjithëse si pasojë e vërsimeve.

-Duke pasur parasysh se janë regjistruar vlera të shtuara të turbullirës në shumë burime, si pasojë ka vështirësi në trajtim të ujit në zonat me të dhënat e përditësuara (24 Janar 2023):

KRU "Prishtina"- Rajoni Prishtinë: Fabrika në Shkabaj mbetet jashtë funksionit.

Fabrika në Drenas ka ndërprerë trajtimin e ujit për shkak të turbullirës.

Për shkak të uljes së kapacitetit prodhues janë duke u zbatuar restriksione në tërë zonat e shërbimit të KRU-Prishtina.

Të gjitha mostrat e testuara në laboratorët e IKSHPK janë brenda standardeve për ujë të pijshëm sipas Udhëzimit Administrativ Nr.10/21 për cilësi dhe konsum human.

Klori rezidual në rrjetin shpërndarës është 0,2mg-0,3mg/L.

Rekomandohet që uji para përdorimit të vlohet.

KRU "Mitrovica"- Rajoni Mitrovicë: Fabrikat në Shipol- Mitrovicë dhe në Balicë- Vushtrrisë janë në funksion të plotë me trajtimin e ujit.

Në mostrat e grumbulluara, analizat laboratorike fiziko-kimike dhe bakteriologjike rezultojnë brenda standardeve.

Klori rezidual në rrjetin shpërndarës është 0,3mg-0,5mg/L në Mitrovicë, Vushtri.

Në Skenderaj mostrat e ujit nuk i përgjigjen standardeve të ujit të pijshëm.

Rekomandohet që uji patjetër të vlohet para përdorimit.

Për shkak të vërsimeve uji i puseve nuk është i sigurt dhe duhet patjetër të vlohet para përdorimit.



KRU "Hidrodrini"- Rajoni i Pejës: burimin Drini i Bardhë –Radavc dhe burimi Shkozë, Junik.

Turbullira vazhdon me qenë prezente në burimet Burimi Drini i Bardhë-Radavc dhe burimi Shkozë-Junik.

Rekomandohet që uji patjetër të vlohet para përdorimit.

Ndërsa për shkak të vërshimeve dhe prurjeve në burime është ndërprerë furnizimi me ujë nga burimi Jarinë - Klinë dhe tani furnizimi bëhet vetëm nga fabrika e ujit në Klinë. Mostrat e ujit nuk i përgjigjen standardeve të ujit të pijshëm. Rekomandohet që uji patjetër të vlohet para përdorimit.

Burimi i Istogut paraqitet akoma me turbullirë, nuk rekomandohet për pije dhe para përdorimit duhet të vlohet.

Të gjitha mostrat e testuara në laboratorët e QRSHP - Pejë janë brenda standardeve për ujë të pijshëm sipas Udhëzimit Administrativ Nr.10/21 për cilësi dhe konsum human.

Klori rezidual në rrjetin shpërndarës është 0.1mg-0,3mg/L. -KRU "Gjakovë"- Rajoni i Gjakovës:

Në zonat e furnizimit nga KRU" Gjakova" gjendja e cilësisë së ujit të pijes është e qetë. Të gjitha mostrat e analizuar janë brenda standardeve të parapara për ujin e pijshëm.

Klori rezidual në rrjetin shpërndarës është 0,3mg-0,35mg/L.

KRU "Bifurkacioni"- Rajoni Ferizaj: fabrika në Pleshinë dhe sistemi në Kaçanik.

Të gjitha mostrat e ujit të cilat janë marrë në Ferizaj dhe Kaçanik janë brenda standardeve për ujin e pijes.

Klori rezidual në rrjetin shpërndarës është 0,2mg-0,3mg/L.

Në ujësjellësin e Hanit të Elezit dhe Shtërpçës, mostrat e ujit nuk përmbushin standardin.

Klori rezidual në rrjetin shpërndarës është 0,02mg/L.

Rekomandohet që uji para përdorimit të vlohet.

KRU "Hidromorava"- Rajoni Gjilan:

Të gjitha mostrat e ujit të cilat janë marrë në Gjilan janë brenda standardeve për ujin e pijes.

Klori rezidual në rrjetin shpërndarës është 0,1mg-0,2mg/L.

Për shkak të shtimit të turbullirës, fabrika në Letnicë-Viti ka ndërprerë furnizimin me ujë të pijes dhe ende është jashtë funksionit.

Rekomandohet që uji patjetër të vlohet para përdorimit.

IKSHPK/Qendra e ujit për pije rekomandon dhe apelon qytetarët që:

-Uji para përdorimit patjetër të vlohet si masë e sigurisë bakteriologjike, e zbatueshme në situata me turbullirë të shtuar në resurse për të parandaluar shpërthimin e epidemive hidrike. Kjo procedure e vlimit të ujit është aq e thjeshtë dhe e zakonshme, por e domosdoshme për të parandaluar shpërthime epidemike.



Të shfrytëzohen resurset e sigurta ose uji i ambalazhuar.

IKSHPK / Qendra e Ujit për pije rekomandon të gjitha Kompanitë Rajonale të Ujësllësit (KRU) me qëllim të stabilizimit të furnizimit:

- Përcjellja e vlerave të turbullirës dhe kujdes i shtuar në procesin e trajtimit
- Kujdes i shtuar në procesin e dezinfektimit
- Mbrojtje të stabilimenteve dhe të burimeve
- Sanimin e gjendjes aktuale në rast të defekteve teknike
- Riparimi dhe deblokimi i pusetave
- Sanimi i dëmtimeve në rrjetin shpërndarës

Bashkëveprimi i IKSHPK/QU dhe KRU-ve me institucionet shtetërore është në kontinuitet deri në qetësimin e situatës.

-Ekipet e Institutit Kombëtar janë në gjendje gatishmërie dhe vazhdojnë me monitorim të rregullt dhe në dispozicion me të gjitha kapacitetet për të ruajtur situatën stabile dhe për çdo përkeqësim të situatës epidemiologjike do të informoheni në kohë reale.

-Uji në rrjetet shpërndarëse është normalizuar dhe është brenda standardeve të parapara për ujë të pijshëm.

-IKSHPK/Qendra e ujit rekomandon dhe apelon qytetarët që:

-Uji para përdorimit patjetër të vlohet si masë e sigurisë bakteriologjike, e zbatueshme në situata me turbullirë të shtuar në resurse për të parandaluar shpërthimin e epidemive hidrike. Kjo procedure e vlimit të ujit është aq e thjeshtë dhe e zakonshme, por e domosdoshme për të parandaluar shpërthime epidemike.

Të shfrytëzohen resurset e sigurta ose uji i ambalazhuar.

-IKSHPK / Qendra e Ujit për pije rekomandon të gjitha Kompanitë Rajonale të Ujësllësit (KRU) me qëllim të stabilizimit të furnizimit:

- Përcjellja e vlerave të turbullirës dhe kujdes i shtuar në procesin e trajtimit;
- Kujdes i shtuar në procesin e dezinfektimit;
- Mbrojtje të stabilimenteve dhe të burimeve;
- Sanimin e gjendjes aktuale në rast të defekteve teknike;
- Riparimi dhe deblokimi i pusetave;
- Sanimi i demtimeve në rrjetin shpërndarës.



Bashkëveprimi i IKShPK/QU dhe KRU-ve me institucionet shtetërore është në kontinuitet deri në qetësimin e situatës.

-Ekipet e Institutit Kombëtar janë në gjendje gatishmërie dhe vazhdojnë me monitorim të rregullt dhe në dispozicion me të gjitha kapacitetet për të ruajtur situatën stabile dhe për çdo përkeqësim të situates epidemiologjike do të informoheni në kohë reale.



10 PELLGJET LUMORE DHE KOMUNAT

10.1. PELLGU LUMOR IBËR-SITNICA

10.1.1. Komuna e Mitrovicës me datë 19.01.2023

Kryetari Hamza, pas reshjeve të shiut shpall gjendje emergjente në Mitrovicë.

Kryetari i Komunës së Mitrovicës z. Bedri Hamza, pas vlerësimit të gjendjes së shkaktuar nga reshjet e shiut dhe koordinimit me drejtorinë përkatëse ka formuar-aktivizuar Qendrën Operative Emergjente për Menaxhimin dhe Monitorimin e situatës së shkaktuar nga reshjet e shiut. Me këtë rast, Qendra Operative Emergjente ka mbajtur edhe një takim të jashtëzakonshëm, ku u diskutua për gjendjen aktuale me të cilën po përballon qyteti i Mitrovicës, si pasojë e reshjeve atmosferike.

Hapja e këtij takimi është bërë nga kryetari i komunës, z. Bedri Hamza, i cili pasi i ka njoftuar anëtarët me situatën aktuale në Mitrovicë, ka shpallur gjendje emergjente, si pasojë e të reshurave të dendura të shiut. Në fjalën e tij, kryetari Hamza ka theksuar se si rrjedhojë e reshjeve të pandërprera, është rënduar situata në përgjithësi, dhe në bazë të kompetencave dhe autorizimeve, kam marrë vendim që të shpallim gjendje të jashtëzakonshme në të gjithë territorin e komunës së Mitrovicës.

Qendra Operative Emergjente për Menaxhimin dhe Monitorimin e situatës së shkaktuar nga reshjet e shiut është në përbërje: drejtoritë komunale; Policia e Kosovës, Njësi i Zjarrfikësve, Forca e Sigurisë së Kosovës, Qendra Operative Rajonale, Ujësjellësi, Kompania për Distribim me Energji Elektrike (KEDS), Kryqi i Kuq, Ekipi i Kërkim - Shpëtimit si dhe Klubi i Zhytësve.

Anëtarët e qendrës operative kanë bërë edhe një apel ndaj qytetarëve për kujdes të shtuar në qarkullim, deri në tejkalimin e kësaj gjendje.



Fotografia 40. Takim në Komunën e Mitrovicës dhe në terren

Me datë 20.01.2023, Kryetari Hamza vlerëson mobilizimin e akterëve të ndryshëm në tejkalimin e situatës emergjente në Mitrovicë

Kryetari i Komunës së Mitrovicës, z. Bedri Hamza, ka pritur në takim kryeinspektorin e AME-së, z. Kastriot Lajçi- këshilltarin politik të MPB- së, z. Lorik Lipoveci- kryeshefin ekzekutiv të Ujësjellësit Rajonal “Mitrovica”, z. Bashkim Kurti si dhe drejtorin e Njesisë së Zjarrfikësve në Mitrovicë, z. Tahir Mikullovc.

Gjatë këtij takimi, kryetari Hamza, ka njoftuar të pranishmit lidhur me gjendjen e përgjithshme në Mitrovicë, të shkaktuar si pasojë e vërshimeve dhe përmbytjeve nga dita e djeshme.

Po ashtu, kryetari Hamza ka falënderuar të pranishmit për gatishmërinë e treguar që brenda kompetencave të tyre t'i dilet në ndihmë familjeve që pësuan dëme materiale.



Edhe nga ana e të pranishmëve është bërë e ditur se vetëm të mobilizuar e së bashku mund të tejkalohen situata të tilla të cila prekin drejtpërdrejtë jetën e qytetarëve të vendit tonë.



Fotografia 41. Kryetari i Komunës së Mitrovicës në takim me AME

Mbahet mbledhja e Qendrës Operative Emergjente Lokale për Menaxhimin e Vërshimeve. Lidhur me menaxhimin e situatës, kryetari i komunës, z. Bedri Hamza, fillimisht ka falënderuar për angazhim të gjithë akterët relevant duke përmendur Policinë e Kosovës, Zjarrfikësit, Ndërmarrjet të cilat operojnë në Komunën e Mitrovicës, FSK-në, Kryqin e Kuq dhe falënderim të veçantë edhe për Klubin e Zhytësve.



Fotografia 42. Takim i të gjitha strukturave kumunale

Në këtë takim kryetari i komunës, z. Bedri Hamza, bëri një rezymë të përgjithshme. “Më shumë se 40 familje janë evakuar në gjithë qytetin dhe pasojat janë shumë të mëdha. Mbi të gjitha fatmirësisht nuk kemi pasur humbje të njerëzve. Ata kanë nevojë për gjithçka, pasi që shtëpitë janë të pabanueshme dhe urgjent duhet t’i qëndrojmë pranë njerëzve me pako ushqimore, veshmbathje, si dhe duhet të bëhet identifikimi i familjeve që janë pa strehë, t’i vendosim me qira dhe komuna të merr përsipër pagesën e qirasë”, ka thënë kryetari z. Hamza.

Me këtë rast, kryetari z. Hamza ka kërkuar nga drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj. Igballe Islami, të kryen të gjitha veprimet e nevojshme që buxheti të jetë operacional dhe të jenë në dispozicion mjetet të cilat do të shërbejnë për t’iu dalë në ndihmë qytetarëve. Qendra Operative Emergjente Lokale do të qëndroj pranë të gjithë banorëve të atyre lagjeve ku janë prekur nga vërshimet, duke i ndihmuar dhe mbështetur ata dhe se komisionet komunale vlerësuese shumë shpejt pritet të dalin në teren për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet.



Qytetarët që kanë nevojë emergjente mund të thërrasin në Qendrën Operative Emergjente 112 dhe në Policinë e Kosovës, në numër të telefonit 192.

Kryetari i Komunës së Mitrovicës, z. Bedri Hamza, gjatë ditës së sotme ka mbajtur takim me operatorët ekonomik dhe lokal të komunës së Mitrovicës për menaxhimin e situatave emergjente, të cilët i ka falënderuar për kontributin dhe gatishmërinë e tyre të treguar me rastin e vërshimeve në Mitrovicë.

Një situatë të tillë me të cilën po përballlet qyteti i Mitrovicës si pasojë e të reshurave të shiut dhe vërshimeve të shumta, çmoj lartë kontributin dhe vullnetin tuaj të treguar në tejkalimin e kësaj situatë.

Krahas përgjegjësive të ndërmarra nga niveli lokal kërkoj nga ju, që me kapacitetet tuaja maksimale t'i dilni në ndihmë bashkëqytetarëve, deri në normalizimin e plotë të gjendjes. Komuna e Mitrovicës formon tri komisione për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet.

Pas vërshimeve të shkaktuara nga reshjet e fundit të shiut dhe dëmeve të konsiderueshme materiale, Komuna e Mitrovicës ka formuar tri komisione AD- HOC për vlerësimin e këtyre dëmeve.

Një komision është formuar për të bërë vlerësimin e dëmeve : ekonomitë familjare, biznese, infrastrukturë dhe bujqësi, me rastin e fatkeqësive natyrore- vërshimeve në Komunën e Mitrovicës.

Këto komisione komunale janë bërë me qëllim të reagimit të menjëhershëm në terren, me ç' rast anëtarët e komisioneve sot kanë dalë në vizitë tek të gjitha ato familje, biznese, qytetarë të cilët janë prekur nga vërshimet, për t'iu dalë në ndihmë.

Kanë rekomanduar secilin qytetarë, familje dhe subjekte afariste që kanë pësuar dëme nga vërshimet të drejtohen në komunë, qoftë me ndonjë dëshmi si fotografi, video- xhirim, në mënyrë që komuna t'i subvencionoj për dëmet e pësuar.

Me datë 21.01.2023. Komuna e Mitrovicës ka evakuuar 16 familje në lagjen "Adem Voca", Pas situatës së krijuar nga vërshimet dhe rritjes së nivelit të ujit nga lumi Ibër.



Fotografia 43. Shpërndarja e ndihmave për banorët e zonave vërshuese

Evakuimi i këtyre familjeve është bërë nga ekipet emergjente komunale, me ç' rast është zgjidhur çështja e banimit, duke i strehuar në objekte të kontraktuara nga komuna si dhe janë furnizuar me ushqim të rregullt, veshmbathje dhe pako higjienike. Komuna e Mitrovicës do të vazhdojë të qëndrojë afër të gjithë qytetarëve.



Fotografia 44. Mobilizimi i shëndetsis për banorët e zonave vërshuese

Ekipet mjekësore të QKMF-së vizitojnë qytetarët e evakuar nga rruga “Adem Voca”.

Gjatë ditës së sotme një ekip mjekësor nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr. Nexhat Çuni” kanë vizituar qytetarët e evakuar nga rruga “Adem Voca”, të cilët janë strehuar tek Ura e Gjakut, nga ekipet komunale. Gjatë vizitës ekipi mjekësor ka konstatuar se gjendja shëndetësore e pacientëve është stabile, duke u ofruar atyre të gjitha shërbimet mjekësore dhe barnat e nevojshme.

QKMF-ja ka kapacitete të mjaftueshme qoftë me personel mjekësor, apo me barna dhe materiale mjekësore për të qenë më pranë qytetarëve në këtë situatë (fazë) emergjente të cilën po e kalojmë. Kryetari Hamza vizitoi zonat e dëmtuara nga vërshimet në Mitrovicë.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza, i shoqëruar nga nënkryetari z. Arian Tahiri si dhe drejtorët komunal, gjatë ditës së sotme kanë vizituar disa lokalitete të Komunës së Mitrovicës, për të parë më afër gjendjen e vendbanimeve të prekura nga vërshimet si dhe dëmet e shkaktuara në prona publike dhe objekte private.



Fotografia 45. Pamje nga vërshimet në Lisicë

Kryetari Hamza, ka qëndruar për vizitë edhe tek disa familje në lagjen “Iliridë”, për të vazhduar më pas edhe me inspektime në fshatin Lisicë



Fotografia 46. Dëmet e shkaktuara në Komunën e Mitrovicës

Ne lagjen “Tjegullorja”, ku si pasojë e vërshimeve të lumit „Lushta”, u shkaktuan dëme të mëdha materiale, dhe si rrjedhojë u ndodhëm në një gjendje emergjente.

Gjatë kësaj vizite kryetari Hamza takoi edhe një grup të rinjsh nga organizata “7 Arte”, të cilët janë mobilizuar për pastrimin sipërfaqësor të lagjes së Tjegullores.

Me datë 22 .01.2023, Kryetari i Komunës, z. Bedri Hamza me bashkëpunëtorë, ka pritur në takim kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti, Ministrin e Mbrojtjes, z. Armend Mehaj dhe atë të Ministrië së Administrimit të Pushtetit Lokal, z. Elbert Krasniqi, të cilët i njoftoi me situatën emergjente të krijuar në qytetin e Mitrovicës, pas vërshimeve dhe përmytjeve të mëdha që kapluan qytetin.



Fotografia 47. Vizita e Kryeministrit të Kosovës dhe Kryetarit të Komunës së Mitrovicës

Nga kryetari Hamza është potencuar se fillimisht është bërë një mobilizim i të gjithë akterëve relevant komunal përmes Qendrës Operative Emergjente Lokale për Menaxhimin e Vërshimeve, të cilët janë duke e monitoruar gjendjen në çdo cep të Komunës së Mitrovicës. “Me tërë kapacitetet komunale jemi duke iu përgjigjur situatës emergjente në terren. Fatmirësisht humbje të njerëzve nuk kemi pasur, ndërkohë është bërë edhe evakuimi i shumë familjeve, të cilët janë mbështetur me pako ushqimore, veshmbathje dhe strehim. Tani jemi në fazën e evidentimit dhe vlerësimit të dëmeve, ku si rrjedhojë e gjendjes, dëmet parashihen të jenë jashtëzakonisht të mëdha, jo vetëm në ekonomitë familjare por edhe në biznese, infrastrukturë e bujqësi”, theksoi kryetari Hamza.

Po ashtu, kryetari Hamza ka shtuar se krahas përkrahjes komunale, në një gjendje të tillë nuk duhet munguar edhe mbështetja nga institucionet e nivelit qendror.



Kryetari z. Hamza dhe Kryeministri z. Kurti kanë vizituar fshatin Lisicë, lagjen “2 Korriku” dhe Liqenin Akumulues, lokalitete këto të prekura nga vërshimet në Mitrovicë.



Fotografia 48. Vizita e Kryeministrit të Kosovës dhe Kryetarit të Komunës së Mitrovicës në terren

Ndërsa, nga Kryeministri z. Albin Kurti, është thënë se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe të gjitha institucionet shtetërore do të qëndrojnë pranë banorëve të komunave ku pati (ka) vërshime për t'i ndihmuar e mbështetur ata.

10.1.2. Komuna e Drenasit

Datë 19.01.2023, Të reshurat e dendura të shiut vështirësojnë qarkullimin, në disa zona është përkeqësuar gjendja. Komuna e Drenasit njofton të gjithë qytetarët, se pas të reshurave të vazhdueshme të shiut, disa rrugë, sidomos mbi ura dhe të rrethi në dalje të qytetit, janë bërë vështirë të kalueshme, ndaj kërkojmë nga qytetarët që të kenë kujdes dhe të evitojnë zonat ku ka rrezik qarkullimi.

Ekipe të Emergjente janë në terren dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë përmes kompanisë së kontraktuar, është duke bërë deblokimin e kanalizimeve, aty ku është bllokuar.



Fotografia 49. Vërshimet në Komunën e Drenasit

Kryetari i Komunës së Drenasit-Ramiz Lladrovci, u bënë thirrje qytetarëve që të shmangin daljet pa nevojë dhe t'i shmangen rrugët me vërshime të mëdha (ku vërshimet janë me të dendura). Lladrovci ka kërkuar që qytetarët të kenë mirëkuptim e bashkëpunim, për të tejkaluar gjendjen e krijuar nga të reshurat e dendura të shiut.

Me shpresën që kjo gjendje të tejkalohet, Komuna e Drenasit falënderon qytetarët për mirëkuptim

Datë 10.1.3. Komuna e Podujevës 19.01.2023

Me datë 19.01.2023, Reshjet e dendura të shiut gjatë ditëve të fundit kanë bërë që disa zona në Komunën e Podujevës të përballen me vërshime. Si institucione lokale që nga mëngjesi jemi në teren duke intervenuar në zonat më të prekuara, ku momentalisht kemi 4 ekipe të cilat janë duke intervenuar në këto zona.

Zonat më të prekuara janë; Pakashticë, Kërpimëh, Letanc, Peran dhe Obrancë, po ashtu edhe disa rrugë janë përshkuar nga uji duke vështirësuar qarkullimin në komunikacion. Situata është e menaxhueshme, por me tendencë të përkeqësimit për shkak të reshjeve të pandërprera të shiut.



Fotografia 50. Intervenimet në lumenjë

Apeloj tek të gjithë qytetarët të bashkëpunojnë me ekipet emergjente institucionale, në mënyrë që përmes koordinimit të përbashkët të tejkalohet sa më shpejtë kjo situatë.

Të nderuar qytetarë,

Numrat kontaktues të shërbimeve emergjente në Komunën e Podujevës janë: 03820041083 Ndërsa tek numri +38346619110 mund të shkruani kërkesën tuaj në platformën Viber dhe zyrtarët kompetent do të pranojnë kërkesën tuaj.

Datë 19.01.2023, Podujevë

Bashkë me drejtorin e Shërbimeve Publike, Bahri Selimi vizitua fshatrat Pakashticë, Letanc, Siboc dhe zonat urbane të prekura nga vërshimet. Gjendja në teren është tejet e rëndë, ne kemi angazhuar 5 kompani të cilat po punojnë me kapacitete të plota në intervenim.



Fotografia 51. Reagimi gjatë vërshimeve



Lus qytetarët për kujdes të shtuar, si dhe kërkoj nga ana e tyre të bashkëpunojnë në çdo situatë me ekipet emergjente institucionale. Dua ta siguroj gjithë secilin se ne do të jemi pranë tyre në çdo kohë.



Fotografia 52. Reagimi gjatë vërshimeve

Me datë 20.01.2023, nga orët e hershme të mëngjesit jemi në teren për të përcjellur nga afër situatën e vërshimeve, po intervenojmë në lokalitetet ku situata është më e rënduar dhe mund të përkeqësohet.



Fotografia 53. Reagimi gjatë vërshimeve

Pasi që për disa orë nuk kemi reshje shiu, ka rënë paksa niveli i ujit dhe situata është e menaxhueshme. I falënderoj ekipet emergjente të Stacionit Policor, Brigadën e Zjarrfikësve dhe të gjithë akterët tjerë që po kontribuojnë në tejkalimin e kësaj situatë.



Fotografia 54. Reagimi gjatë vërshimeve

Pas situatës së krijuar nga vërshimet në Komunën e Podujevës, sot është mbajtur mbledhja e Shtabit Emergjent. Mbledhjen e udhëhoqi kryesuesja e shtabit, Nënkryetarja e Komunës, Marigona Lahu, ku të pranishëm ishin edhe përfaqësues nga Stacioni Policor në Podujevë, QKMF-ja dhe anëtarët e tjerë të shtabit nga dikasteret e komunës.



Fotografia 55. Shtabi Emergjent i Komunës së Podujevës

Për situatën e krijuar nga vërshimet foli drejtori i Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Bahri Selimi i cili raportoi për gjendjen e përgjithshme në teren, zonat më të prekura dhe vendet se ku ka intervenuar komuna. Drejtori Selimi tregoi se janë angazhuar 5 kompani të kontraktuara nga komuna, të cilat po punojnë me kapacitete të plota në ofrimin e ndihmës për familjet e prekura nga vërshimet dhe tejkalimin e kësaj situatë.

Për gjendjen e krijuar folën edhe përfaqësuesit nga Stacioni Policor, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, si dhe drejtorë të drejtorive komunale. Në këtë takim u konstatua se gjendja aktuale është plotësisht e menaxhueshme, por si shtab emergjent dhe përfaqësues të institucioneve duhet të jemi vigjilent dhe në gjendje gatishmërie për çdo situatë.

Poashtu, sot është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve të Shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore, i cili ditëve në vijim do të dalë në teren për të evidentuar të gjitha dëmet e shkaktuara në infrastrukturë rrugore, toka bujqësore, shtëpi banimi etj.

Anëtarët e Shtabit Emergjent në fund të takimit u dakorduan të jenë në komunikim të vazhdueshëm, duke përcjellur situatën me reshje të shiut dhe bazuar në këtë të ndërmerren edhe masat e nevojshme

Me datë 21.01.2023 Drejtori Selimi vizitoi zonat e prekura nga vërshimet.

Drejtorja e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim po vazhdojnë vizitat në teren të fshatrave dhe lagjeve të prekura nga vërshimet, ata po përcjellin nga afër situatën e reshjeve dhe përkeqësimit eventual të motit.



Fotografia 56. Dëmet e shkaktuara nga vërshimet

Intervenimet nga Ekipet Emergjente janë bërë edhe gjatë ditës së sotme në sanimin e problemeve në rrjetin e kanalizimit dhe në shtratin e lumenjëve, në mënyrë që të minimizohet rreziku ditëve në vijim nga reshjet e shiut.

Drejtori i kësaj drejtorie, Bahri Selimi tha se situata aktuale me vërshime në Komunën e Podujevës është nën kontroll nga autoritetet lokale, si dhe potencoi se janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme nga institucionet lokale në rast të përkeqësimit të situatës nga reshjet e shiut ditëve në vijim.



Fotografia 57. Makinaria e nevojshme për të reaguar

Kryetari Bulliqi ka vizituar disa nga familjet të cilat kanë pësuar më tepër nga vërshimet ditëve të fundit në Komunën e Podujevës.

“Nga afër kam parë edhe intervenimet që po bëhen nga kompanitë e kontraktuara për zgjerimin e shtratit të lumenjëve dhe sanimin e rrugëve.



Fotografia 58. Dëmet e shkaktuara në biznese dhe shtëpi banimi

Nga vërshimet dëme janë shkaktuar në shtëpi banimi, biznese private, toka bujqësore, ferma të bagëtive, infrastrukturë rrugore etj.



Fotografia 59. Dëmet e shkaktuara ne infrastrukturë rrugore

Ne kemi ngritur Komisionin për Vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, ku tashmë komisioni ka filluar punën për vlerësimin e të gjitha dëmeve të shkaktuara. Pas pranimit të raportit, bazuar në mundësitë tona komunale si dhe duke kërkuar edhe ndihmën e institucioneve qendrore do të ndihmojmë qytetarët tanë“ .



Fotografia 60. Pastrimi i rrugëve nga kompanitë private

Komuna e Podujevës fton qytetarët të lajmërojnë dëmet e shkaktuara nga vërshimet.

Si pasojë e të reshurave të mëdha të shiut ditëve të fundit, shumë fshatra e zona urbane të Komunës së Podujevës janë përballur me vërshime, me qëllim të evidentimit të të gjitha dëmeve të shkaktuara, është krijuar Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve të Shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore.

Komuna e Podujevës fton qytetarët që janë dëmtuar nga vërshimet të paraqesin kërkesat për kompenzim të dëmit në objektin e administratës komunale, në sportelin e shërbimit me qytetarë.

Bazuar në kërkesat e qytetarëve Komisioni Komunal do të dalë në teren dhe do t'i shqyrtojë secilën kërkesë, pas vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga kjo fatkeqësi natyrore komisioni do t'i rekomandoi institucioneve qendrore kompenzimin e dëmeve për qytetarët e Komunës së Podujevës.

10.1.4. Komuna e Mitrovicës së Veriut datë 19.01.2023

Me datë 19.01.2023, reshjet e mëdha të shiut kanë shkaktuar vërshime të mëdha dhe ka rrezikuar një numër të madh të banorëve dhe ekonomive familjare. Një numër i madh qytetarësh u përgjigjën për të ndihmuar në evakuimin e familjeve të vërshuara. Shumë rrugë janë të pakalueshme për shkak të rrëshqitjeve të dheut dhe vërshimit të lumenjve. Sa i përket aktiviteteve të tjera, nuk kemi mundësi t'i bëjmë për shkak të gjendjes ende jostabile dhe të keqe, asnjë institucion në veri nuk funksionon, përfshirë vetëqeverisjen lokale dhe policinë.

Zonat e vërshuara në segmentin nga ura kryesore deri te lumit Sitnica në Ibër, dëmet e shkaktuara nga vërshimet janë të mëdha dhe për momentin mund të përcaktohen vetëm në përgjithësi. Megjithatë, dëmi i vërtetë mund të përcaktohet vetëm pas tërheqjes të ujit në shtratin e lumit Ibër. Gjithashtu, në Dudin Kërsh, ku janë të shpeshta rrëshqitjet e dherave, kemi vërejtur se pas reshjeve të dendura janë shtuar të çarat ndërmjet shkëmbinjve që kanë ekzistuar më parë dhe se ekziston mundësia e rënies së shkëmbinjve të rinj në rrugën kryesore.



Fotografia 61. Rruga kryesore të Dudi Kërshi



Qytetarët kanë raportuar dëme nga vërshimet në mënyrë që te vlerësohen dëmet.



Fotografia 62. Lagjja e boshnjakëve

Aleksandar Arsenijeviq nga Iniciativa Qytetare “Mbijetesa Serbe” ka thënë se policia së bashku me zjarrfikësit kanë ndihmuar një familje që të evakujnë nga shtëpia, pasi uji ka depërtuar brenda shtëpisë së tyre.

“Këtu jam që nga orët e mëngjesit për t’iu ndihmuar fqinjëve në qytetin tone. Që në fillim kanë qenë zjarrfikësit ngase situata nuk ishte aq alarmante. Ata e kanë mbajtur situatën nën kontrollë, mirëpo, ndërkohë vërshimet e ujit janë rritë ka ndodhur që vërshimet e ujit është rritur. Një person ka mbetur i ngujuar dhe ka refuzuar të dalë nga shtëpia. Më vonë policia dhe familja e tij kanë intervenuar për ta evakuuar personin që të mos përmbytej” – deklaroi Aleksandar Arsenijeviq.

Situatë e ngjajshme është edhe në Lagjën e Boshnjakëve në veri, ku një qytetari ka rrëfyer për gazetën Kallxo.com, se po mbushin thasë me zhavorr, në mënyrë që të parandalohet hyrja e ujit nëpër shtëpi. “Për momentin kjo është gjendja, nëpër shtëpia, si serbëve si neve por jemi duke i përgatitë disa thasë me zhavorr që me u mundu me ndalu që mos të hyjë uji tek të gjithë nëpër shtëpia.” – citohet të ketë thënë ai për mediumin në fjalë.



Fotografia 63. Në Mitrovicën Veriore

Banorët që nuk mund të dilnin nga shtëpitë u evakuuan. Më saktësisht, 120 familje nga 11 shtëpi dhe objekte nga banesat në katin përdhes dhe bodrum. Sipas informacioneve tona, shumë prej tyre duke qenë se nuk kishin ku të shkonin, ishin vendosur në Konviktin Studentor. Me këtë rast dëshirojmë të lavdërojmë Policinë e Kosovës nga rajoni i Veriut, përveç zjarrfikësve, të cilët edhe pse kanë kohë që punojnë në kushte të vështira, arrijnë të ndihmojnë qytetarët e prekur vulnerabël, përtej mundësive të tyre.

- Uji nga tubacioni i pikës nuk është për pije. Ata raportuan në mediat lokale se uji nuk ishte i pijshëm dhe se në tre vende të qytetit ishin vendosur depozita të ujit të pijshëm. Duke vizituar ambjentet, konstatuam se në shëtitoren e qytetit dhe në pozicionin pranë "Tre Solitaires" ishin vendosur cisterna me ujë të pijshëm.

Me respekt,
Inspektorë nga Mitrovica Veriore
Veroljub Petroniq
Ljubisha Peshaković
Pedja Janićijević



10.1.5. Komuna e Leposaviqit datë 19.01.2023

Me datë 19.01.2023, Komuna e Leposaviqit është vërsuar shkak i reshjeve të shumta. Në shumë fshatra dhe vendbanime kanë ndodhur vërshime, po ashtu si pasojë e gjithë kësaj, janë shfaqur rrëshqitje të reja dhe kanë aktivizuar ato ekzistuese. Shumë familje, rrugë, tokë të punueshme janë përbytur, si dhe janë rrezikuar disa ura. Në momentin e shkrimit të raportit, reshjet janë dobësuar dhe shpresojmë që uji të fillojë të zvogëlohet dhe të mundësojë sanimin e pasojave dhe ndihmë për njerëzit e prekur nga kjo fatkeqësi. Gjithashtu, në periudhën në vijim do të mundohemi të vizitojmë sa më shumë lokacione të goditura dhe t'i regjistrojmë me foto dhe raport më të detajua. Në komunën e Leposaviqit gjendet lumi Ibër dhe shumë degë të tij, ku për shkak të reshjeve të shumta derdhen edhe degët e shumta të tij. Këtë javë vizituam lumin Josanica, i cili shtrihet nga miniera e Crnacet deri në bashkimin me lumin Ibër, afër pjesës urbane të Leposaviqit, më saktësisht afër fshatit Popovcë. Gjatësia e lumit është rreth 17 kilometra dhe përgjatë gjithë rrjedhës së tij kalon nëpër vendbanime dhe fshatra. Ai ka shkaktuar dëme të konsiderueshme si në banesa dhe objekte ndihmëse, ashtu edhe në sipërfaqe të tokës së punueshme, siç mund ta shihni duke parë fotot që ju dërgojmë me raport. Gjithashtu ka dëmtime në rrugë dhe ura, ku një urë u shkatërrua totalisht. Duhet të theksojmë se banorët e atyre vendbanimeve u organizuan dhe filluan të rehabilitojnë pasojat e këtyre vërshimeve në këtë zonë. Gjithashtu besojmë se këtu është i domosdoshëm rehabilitimi i shtratit të lumit, si dhe forcimi i tij në shumë vende, gjë që shihet edhe në foto.



Fotografia 64. Vërshimet në Komunën e Leposaviqit

Javën e ardhshme do të vazhdojmë punën tonë dhe do të bëjmë një xhiro nëpër lum përmes vendbanimit Tvrdjan, i cili është degë e lumit Ibër dhe i cili gjithashtu është prekur dhe ka shkaktuar probleme të mëdha duke pasur parasysh se kalon nëpër një pjesë të zones urbane të Leposavicit.



Fotografia 65. Vërshimet në Komunën e Leposaviqit


Vërshime të shpejta nga lumenjet malore të bregut të majtë të Ibër, të shkaktuara nga reshjet e shiut, demtuan rrugë dhe ura në komunën e Leposavicit.

Zona më e rrezikuara ndaj vershimeve në Kosovën Veriore, afër urës së fshatit Postenje, e cila është e demtuar dhe ka shpëputë vendbanimin e Kuzmanovicit, ku banoret do të detyrohen të përdorin rrugë të tjera. Shumë ura dhe rrugë të tjera janë demtuar. Mbyllet rruga Vracevo dhe Sveti Vraci për shkak të sigurisë.



Fotografia 66. Dëmtimi i urës në Komunën e Leposaviqit

Dëmi është gjithashtu i dukshëm në një numër të madh të fermave bujqësore. Si rezultat i përmbytjeve të lumit Ibër në fshatin Borova, katër (4) ekonomi familjare, shtëpi dhe objekte ndihmëse janë shkatërruar, kështu që këto familje kaluan natën tek të afërmit e tyre. Shtëpitë dhe objektet ndihmëse gjithashtu u vërshtuan në fshatin Gornji Kërnjin dhe Kajkovo, ku një fermë e derrave u vërshtua. Gjithashtu, rrugët që çojnë në fshatrat Kutnje, Pridvorica, Kosutica, po ashtu fshatrat Ibarsko Psotenje dhe Donji Krnjin, janë shpëputur.



Fotografia 67. Vërshimet në fshatrat e Komunës së Leposaviqit

“Në fshatin Vuçe, gjatë përmbytjeve të lumit Vucan, tri ekonomi familjare janë vërshtuar, dy ura në fshatin Mekinice janë shembur dhe ura në fshatin Mialice është dëmtuar, ura në fshatin Josanicë gjithashtu është shembur tërësisht, gjersa ura në rrugën e fshatit Josanicë, Popovc, Gnjezdane, Duboka, PLakaonicë dhe drejt minierës aktive Crnac është dëmtuar dukshëm.

“Fshatrat Kosuticë, Pridvoricë, Grkajë janë izoluar për shkak të rrëshqitjes së dheut në shumë rrugë. Në mënyrë që t’i përgjigjen të gjitha sfidave në pajtimin me situatën e re të krijuar, komuna e Leposaviqit ka formuar komisionin për përcaktimin e dëmeve të shkaktuara, tek të dy familjet dhe objektet ndihmëse, po ashtu fermat bujqësore, të gjitha me qëllim të sigurimit të asistencës për familjet e pambrojtura dhe për zonat e vërshtuara dhe të largohen dëmet sa më shpejt, raporton Kosova Online.



10.1.6. Komuna e Zveçanit

Me datë 19.01. 2023: Zonat e vërshura në komunën e Zveçanit, më saktësisht janë në Banjskë. Në bisedë me vendasit na thanë se dëmet ishin të mëdha, ne vetë pamë këndin e lojërave të përmbytura, shtyllat e rrymës të përmbysur dhe shtretërit e lumenjve të dëmtuar. Një sasi e madhe uji ka dëmtuar edhe disa ferma private dhe toka bujqësore. Ne kemi bashkangjitur disa foto.



Fotografia 68. Vërshimet në Komunën e Zveçanit

Milutin Vasović
Slobodan Andjelković
Ranko Vukashinović

Gjatë reshjeve të mëdha të shiut që zgjatën më shumë se 15 orë në pjesën veriore të Kosovës, përrrenjtë të rrëmbyeshëm, shkaktuan probleme për banorët e veriut, sidomos në komunën e Zveçanit, ku vërshuan përrrenjtë dhe lumenjtë, ku situata më e veshtirë është në fshatin Josevik dhe Zeronicë, ku uji ka hyrë nëpër shtëpi. Janë duke u pastruar rrugë nga shërbimet për mirëmbajtjen në terren, po ashtu edhe zjarrëfikësit po mundohen t'a zvogëlojnë dëmin dhe t'i mbrojnë familjet me argjintura të shtuara.



Fotografia 69. Dëmtimi i rrugëve nga vërshimet në Komunën e Zveçanit

Në 50 vitet e fundit kjo situatë është më e veshtira. Ne kemi probleme shqetësuese me vërshimet dhe niveli i lumit Ibër po rritet pothuajse në të gjitha pikat. Të gjithë jemi në rrezik. Më shumë se 50 shtëpi janë vërshuar për momentin, situatë më e keqe është në Grabovac ku aty ka ndodhë një rrëshqije e madhe e dheut dhe i ka rrënuar shtyllat elektrike, ku për fat nuk ka ra mbi shtëpi sepse, atehere do te ndodhte ndonje tragjedi.



Fotografia 70. Dëmtimi i urave në Komunën e Zveçanit



Fotografia 71. Dëmtimi i rrugëve nga vërshimet në Komunën e Zveçanit

Së bashku po përpiqemi me të gjitha ekipet e angazhuara të gjitha ekipet janë angazhuar, mirëpo nuk po mundemi të arrijmë të gjitha sepse vazhdimisht kemi raportime të reja nga qytetarët.

Milutin Vasović
Sllobodan Andjelković
Ranko Vukashinović

10.1.7. Komuna e Zubin Potokut

Me datë 19.01.2023

Lumi Suhodoll del prej shtratit në rrugët e përmes rrugëve të Zubin Potokut duke vërshuar shumë shtëpi të vëndosura në zonat në të ulëta përgjatë lumit. Rrugët kryesore dhe lokale janë të bllokuara në shumë vende prej rrëshqitjeve të mëdha të dheut, kështu që qasja për te komuna është bllokuar në të gjitha anët. Dëmtimi i kulmeve është i dukshëm në shumë ndërtesa në Zubin Potok, ndërsa impianti i fabrikës “Simpò” në fshatin Uglar gjithashtu është vërshuar. Në fshatin Shtuocë, pjesë të shembura të kodrës e groposën një tunel, ndërsa në fshatin Donje Varage, një rrëshqitje e dheut ka mbyllur autostraden kryesore në dy pjesë Ribaricë- Mitrovicë.



Fotografia 72. Vërshimet në Komunën e Zubin Potokut

Fshati Strmac gjithashtu është prekur nga vërshimet dhe pjesë të rrugës së re e ndërtuar para një viti është shkatërruar tërësisht. Fshatrat Dren, Prevlak, Crepulja dhe Jabuka janë shpërndarë nga pjesa tjetër e komunës, ndërsa rrugës për në Zubin Potok (prej Mitrovicës) nga drejtimi i Mitrovicës janë bllokuar nga të dy anët.



Fotografia 73. Gjatë intervenimit në Komunën e Zubin Potokut

Drejtori i JP “Ibri”, Marko Vulovic, tregoi se punëtorët e kësaj kompanie po kontrollojnë sigurinë dhe funksionimin e duhur të digave të liqenit Gazivodë në Zubin Potok dhe se uji është duke u lëshuar në mënyrë të kontrolluar përmes një prej katër(4) derdhjeve të digës kryesore.



“Në mënyrë që të mos presim që niveli i ujit të rritet e të mos kemi hapësirë për reagim pastaj, filluam me kohë të lëshojmë 100 m³ ujë, kështu që edhe tani uji është duke u lëshuar në mënyrë të kontrolluar. Nuk duhet të ndryshohet niveli. Mund të rritet pak.

Për momentin, prurjet e tjera gjithashtu kanë rënie, sic është Lumi Lucka dhe kjo është në favorin tonë, vetëm nese nuk kemi përsëri reshje të mëdha shiu dhe të ndodh prapë dicka e papritur, për momentin nuk duhet të këtë ndryshime të mëdha në Zubin Potok, as edhe në Mitrovicë ”sqaroi Vulovic, duke deklaruar se rezervuari i Gazivodës nuk ka arritur maksimumin edhe pse vërshimi ka kaluar pikën, kështu që nuk ka vend për panikë”.



Fotografia 74. Qytetari në kohën e vërshimeve në Komunën e Zubin Potokut

Situata në Zubin Potok është më se e jashtëzakonshme dhe banorët thonë se nuk mbahet mend që kjo komunë ndonjëherë është godit nga vërshimet në këtë mënyrë.

Gjithcka është zhdukur, gjithcka cka patëm në shtëpi dhe para shtëpisë, shpezët, drunjt për zjarrë, cdo gjë që e kemi ndërtuar pak nga pak ndër vite, të gjithë mundin e investuar këtu,” thotë me lotë në sy Slavisha.

10.2. PELLGU LUMOR DRINI I BARDHË

10.2.1. Komuna e Skenderajit

Me datë 19.01.2023 - Duke iu përgjigjur situatës së krijuar pas të reshurave të pandërprera, që kanë shkaktuar vërshime dhe dëme të konsiderueshme materiale, Kryetari i Komunës, Fadil Nura dhe Nënkyetari Sami Lushtaku në takimin e sotëm në orët e hershme të mëngjesit me Bordin e Drejtorëve, kanë marrë vendim që të themelojnë 11 komisione komunale me nga 5 anëtarë secili, të cilët menjëherë do të dalin në teren për të bërë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara.



Fotografia 75. Takim me zyrtarët e Komunës së Skenderajit

Për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme të shpallur gjatë ditës së djeshme, si pasojë e situatës që kërkon reagim të menjëhershëm në teren, sot një pjesë e shërbimeve komunale është e pamundur të ofrohen.


Komuna e Skenderajt njofton se nuk do të ketë orar të punës për ekzekutivin komunal, deri në përfundimin e procesit të vlerësimit të tërësishëm të dëmeve materiale.

Në këtë kuadër, kërkohet nga qytetarët që të ruajnë provat (video-xhirim, fotografi) të dëmeve të pronave të luajtshme dhe të paluajtshme.

Komuna e Skenderajt do të bëjë njoftime të kohëpaskohshme lidhur me situatën në përgjithësi.

Me datë 20.01.2023- ndërkohë që puna sot filloi para orarit zyrtar, një ditë pas asaj që nuk ishte mbajtur në mend për më shumë se 50 vite, me takimin e Kryetarit Nura dhe Nënkyetarit Lushtaku me drejtorët e ekzekutivit, ku u formuan 11 komisione për të nisur procesin e vlerësimit të dëmeve, e që filluan pa humbur kohë këtë vlerësim, vizitat nisën tek familjet që ishin prekur nga vërshimet e jashtëzakonshme, duke u gjendur qëndruar pranë tyre në këto momente të rënda.

U vizituan fillimisht bizneset afariste në qytet të cilat në masë të madhe janë dëmtuar.



Fotografia 76. Vërshimet në qytetin e Skenderajit

U vazhdua me fshatin Llaushë, ku gjendja dukej tepër e rëndë, ku urat e lumit janë shkatërruar plotësisht.



Fotografia 77. Dëmtimet në infrastrukturën rrugore dhe biznese në Komunën e Skenderajt

Edhe Tushila kishte fatin e njëjtë. Shtëpi të dëmtuara në shkallë të gjerë, bagëti të mbytura dhe tokat bujqësore të përmytura, janë gjithçka ka mbetur prapa.

Janë vizituar edhe fshatrat Kllodernicë, Klinë e Epërme dhe Kuqicë, të cilat janë prekur më së shumti. Shirat e rrëmbyeshëm të ditës së djeshme, përveç dëmeve tashmë të ditura, kanë shkatërruar edhe urat, që ka vështirësuar edhe qarkullimin e qytetarëve.

Megjithëkëtë, Komuna e Skenderajt, po bën të pamundurën që t'u dilet në ndihmë secilës familje të prekur nga kjo gjendje.

Gjatë gjithë ditës Ekipi Emergjent ka vazhduar me shpërndarjen e ushqimeve tek familjet të cilat janë të prekura nga vërshimet dhe nuk kanë mundësi të furnizimit me ushqime dhe gjësende të tjera.



Fotografia 78. Pamje nga vërshimet në Komunën e Skenderajt

Ndonëse situata me reshje është qetësuar, shumë familje shtëpitë e të cilave janë përfshirë në ujë, kanë nevojë për ndihmën tonë me gjëra ushqimore, veshmbathje, batanije, higjienë dhe gjëra të tjera të nevojshme.



Fotografia 79. Ndhimja për banorët e prekur nga vërshimet

Është urgjente që t'u dalim në ndihmë në këto momente të vështira



Fotografia 80. Mobilizimi i ndihmave për banorët e prekur nga vërshimet



**FALEMINDERIT LIPJAN, MITROVICË, VUSHTRRI, PRIZREN, FERIZAJ, DEÇAN, OBILIQ, GJAKOVË,
PEJË, ISTOG, KLINË**



Fotografia 81. Organizimi dhe mobilizimi për grumbullimin e produkteve ushqimore

"Në listën e gjatë të kompanive dhe ekipeve të shërbimeve publike dhe jopublike, që po na ndihmojnë të ringritemi dalëngadalë, mirënjohje dhe falënderime për ndërmarrjet "Uniteti", "Pastrimi", "Eko Natyra", "EkoRegjioni" Prizren, KRM "Pastërtia" Ferizaj, NPL "Higjiena" Deçan, NPL "Perparimi" Vushtrri, NPL "Kastrioti" Obiliq, KRU "Gjakova" KRM "Ambienti" Pejë me njësitë e saj në Istog dhe Klinë, me mbi 100 punëtorë të palodhshëm, duke dhënë kontribut në pastrimin e hapësirës së gjerë publike dhe kthimit të jetës normale.



Fotografia 82. Pastrimi i rrugëve dhe objekteve nga mbetjet e vërsimeve

Ndërkohë që është shkollat po bëhen gati për t'i pritur nxënësit, falë angazhimit të personelit arsimor dhe teknik, të cilët po i pastrojnë hapësirat e objekteve dhe po rikthejnë gjerat në vendin e vetë. - Fadil Nura, kryetar i Komunës

Me datë 20-01.2023- Ministri Liburn Aliu vizitoi komunën e Skenderajt në Skenderaj për të parë nga afër dëmet e shkaktuara nga vërshimet e djeshme. Dëme janë shkaktuar në qytet dhe në fshatrat Llaushë, Tushilë, Rezallë e Re dhe disa pjesë tjera të Skenderajt. Po bëjmë të pamundurën për të sanuar situatën e krijuar, dhe fatmirësisht përpos dëmeve të konsiderueshme materiale nuk kemi qytetarë të vdekur e as të lënduar.



Fotografia 83. Pamje nga demtimi i urës nga vërshimet në K. Skenderaj

Kemi krijuar grupet ndërministrorë për t'iu dalë në ndihmë të gjithë qytetarëve që kanë pësuar dëme materiale nga vërshimet e djeshme, dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe të gjitha institucionet shtetërore do të qëndrojnë pranë banorëve të komunave në çdo kohë për ti ndihmuar e mbështetur ata.

Ministrja Rozeta Hajdari-„Vërshimet e ditëve të fundit si pasojë e reshjeve atmosferike kanë vënë në gjendje gadishmërie të gjithë mekanizmat shtetëror për të ndihmuar dhe lehtësuar daljen nga kjo situatë. Pas qëndrimit tonë mbrëmë pranë qytetarëve në komunat Pejë, Istog e Klinë, sonte vizitua edhe komunën Skënderaj.



Fotografia 84. Pamje gjatë solidarizimit me banorët e prekur nga vërshimet

Jemi pranë çdo qytetari dhe biznesi të prekur nga kjo situatë e shkaktuar nga vërshimet, dhe Qeveria e Republikës së Kosovës do të vazhdojë të ndihmojë dhe mbështesë qytetarët dhe të gjitha komunat e prekura me të gjitha kapacitetet e saj“.

10.2.2. Komuna e Klinës

Me datë 19.03.2023 - Kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, bashkë me Nënkryetarën, Marqe Selmanaj, drejtorin e DSHPE-së, Qendrim Millaku dhe atë të Inspektoratit Faruk Smajli, kanë vizituar disa fshatra për të parë nga afër gjendjen e krijuar si rrjedhojë e reshjeve të vazhdueshme të shiut, ku gjendja në shumë fshatra dhe lokalitete është rënduar.



Fotografia 85 Vizita e Kryetarit të Komunës së Klinës Z. Zenun Elezaj në terren

“Në kuadër të kapaciteteve që kemi po angazhohemi për lehtësimin e situatës. Po ashtu, Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Policia e Kosovës vazhdimisht po i përgjigjet kërkesave të qytetarëve. Apeloj qytetarët që të kenë kujdes të shtuar në komunikacion, sepse ka vështirësi në disa rrugë”- ka thënë Elezaj.

Të nderuar qytetarë, mësimdhënës, nxënës:

Duke e parë gjendjen e krijuar si pasojë e reshjeve të vazhdueshme të shiut, ku në disa fshatra qarkullimi është vështirësuar në masë të madhe, Drejtoria Komunale e Arsimit, në konsultim me drejtorë të shkollave dhe prindër, ka vendosur që nesër, ditë e premtë, të mos mbahet mësim në shkollat e komunës së Klinës. Vendimi është marrë për shkaqe të sigurisë së nxënësve, ndërsa për hapat tjerë do të informohen drejtorët e shkollave.

Me datë 20.01.2023. Sot, që nga mëngjesi, Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, bashkë me bashkëpunëtorë të komunës, ka vizituar shumë vende për të parë nga afër gjendjen e krijuar nga vërshimet si pasojë e reshjeve të shumta.



Fotografia 86 Pamje nga vërshimet në Komunën e Klinës

Në disa pjesë të qytetit dhe në shumë fshatra, gjendja është e rëndë dhe ka dëmtime në infrastrukturë rrugore dhe në shtëpi apo biznese private. Pra, dëmi është i konsiderueshëm.



Fotografia 87 Intervenimi i zjarrëfiksive gjatë vërshimeve në Komunën e Klinës

“Ne menjëherë do të formojmë komisionin për vlerësim të dëmeve dhe brenda mundësive buxhetore do t’i ndihmojmë qytetarët e dëmtuar. Gjithsesi do të kërkojmë ndihmë edhe nga Qeveria e Republikës së Kosovës që ta ndajë një fond të veçantë që t’i ndihmohet familjeve të dëmtuara, sepse buxheti komunal është i kufizuar” - ka thënë Elezaj.

Komuna e Klinës, respektivisht Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente, njofton të gjithë qytetarët të cilët kanë pësuar dëme materiale në ekonomitë e tyre familjare dhe bizneseve, të bëjnë menjëherë kërkesë në Komunën e Klinës, në mënyrë që Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve, i formuar nga kryetari i komunës, të del në terren për të vlerësuar gjendjen e dëmeve.

Komuna e Klinës fton qytetarët që të paraqiten në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjente nga data 23 deri me 30 janar për plotësimin e aplikacioneve për vlerësimin e dëmeve.

Kërkesës duhet të ia bashkëngjitni edhe fotografi të gjendjes së krijuar pas vërshimeve, një kopje të letërnjoftimit dhe një konfirmim nga banka për xhirrologarinë e aplikuesit.



Fotografia 88 Objekti i Komunës së Klinës

Kryetari i komunës së Klinës, Zenun Elezaj i shoqëruar nga nënkryetarja znj. Marqe Tanushi Selmanaj dhe bashkëpunëtorë të tjerë ka pritur sot në takim zyrtar Presidenten e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani.



Fotografia 89 Vizita e Presidentes së Kosovës me Kryetarin e Komunës së Klinës

Kryetari Elezaj falënderoi për vizitën dhe interesimin e shprehur për të parë nga afër situatën e krijuar nga reshjet e shiut në Klinë.

“Me Presidenten Osmani diskutuam për gjendjen e krijuar në komunën e Klinës pas vërshimeve dhe sfidat me të cilat po përballlet komuna e Klinës në përgjithësi. E informova atë për nivelin e dëmeve që janë shkaktuar në infrastrukturë rrugore, biznese dhe ekonomi familjare po ashtu edhe për hapat që kemi marrë ne si institucione lokale për t’ju dalë në ndihmë qytetarëve.

Theksova se në vlerësimet e para dëmet janë të konsiderueshme dhe se mundësitë buxhetore të komunës janë të kufizuara për kompensimin e dëmeve dhe përmbushjen e kërkesave të qytetarëve, për çka po ashtu konstatova se është shumë e nevojshme ndihma e Qeverisë së Republikës së Kosovës për riparimet e nevojshme infrastrukturore dhe kompensimin financiar të familjeve apo bizneseve të dëmtuara”, - ka thënë Elezaj.

Po ashtu, edhe Presidentja Osmani theksoi se qytetarët, bizneset dhe familjet e dëmtuara duhet të ndihmohen nga institucionet qendrore dhe lokale për riparimin e dëmeve dhe e shprehu gatishmërinë e saj për të ndikuar dhe ndihmuar në këtë çështje.



Fotografia 90 Vizita e Presidentes dhe Kryetarit të Komunës në terren

Me datë 22.01.2023- Drejtoria Komunale e Arsimit njofton të gjithë nxënësit, mësime dhënësit dhe qytetarët se nesër, më datë 23 janar, rifillon procesi edukativo-mësimor në të gjitha shkollat e komunës së Klinës dhe në çerdhen e qytetit.



Procesi mësues do të vazhdojë me orar të rregullt, ndërsa për datën e zëvendësimit të procesit mësues për ditën e premte do të njoftoheni nga drejtoritë e shkollave përkatëse.

Reshjet e shiut në ditët e fundit kanë lënë shumë dëme pas vete, si në prona publike ashtu edhe ato private.



Fotografia 91 Intervenimi i banorëve gjatë vërshimeve

Ne menjëherë kemi filluar punën për riparimin e tyre, megjithëse është mjaftë sfiduese t'i përmbushim kërkesat e shumta të qytetarëve edhe përkundër bashkëpunimit të shkëlqyer me institucionet relevante, kompanitë e ndryshme dhe angazhimit të madh e të vazhdueshëm. Sot, bashkë me drejtorin e Shërbimeve Publike dhe Emergjente, Qendrim Millaku, kam vizituar punimet në rregullimin e argjinaturave të errodura të lumit Klina.



Fotografia 92 Vizita e Kryetarit të Komunës së Klinës gjatë intervenimit për mbrojtjen nga vërshimet

Po ashtu, kam vizituar edhe ekipet e zjarrfikësve dhe Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave, të cilët po bëjnë një punë të pandalshme për largimin e ujërave nëpër podrumet e shtëpive, të cilët i falënderoj për bashkëpunimin.



Fotografia 93 Takimi i Kryetarit të Klinës me Ministrin e Bujqësisë në terren

Me datë 23.01.2023-Kryetari i Komunës së Klinë Zenun Elezaj, ka pritur sot në një takim zyrtar Ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci.



Fotografia 94 Takimi i Kryetarit të Klinës me Ministrin e Bujqësisë në zyrë të Komunës

Kryetari Elezaj falënderoi për vizitën Ministrin dhe e informoi për investimet që kanë bërë në sektorin e bujqësisë si komunë, sfidat me të cilat përballen bujqit klinas dhe për projektet e planifikuara.

“Me Ministrin Peci kemi vizituar disa bujq dhe fermerë dhe kemi parë nga afër dëmet e shkaktuara në tokat bujqësore nga vërshimet e fundit në komunën e Klinës dhe me theks të veçantë diskutuam për mundësitë e bashkëpunimit për kompensimin e bujqve për humbjet e tyre.



Fotografia 95 Kryetarit të Klinës me Ministrin e Bujqësisë takim me banorët e prekur nga vërshimet

„Theksova gatishmërinë time që bashkë me MBPZH të investojmë për pastrimin e përrrenjve, zgjerimin e shtretërve të lumenjve, rregullimin e kanaleve të ujitjes dhe kërkova nga ai që të ndajë fonde të veçanta të bashkëfinancimit për realizimin e projekteve të tilla të cilat do të ishin shumë të dobishme për bujqit për të rritur rendimentet e tyre si dhe si masë preventive për vërshimet e mundshme”, ka thënë Elezaj.

10.2.3. Komuna e Istogut

Me datë 19.01.2023- Reshjet e mëdha e të pandërprera të shiut në qytetin tonë kanë shkaktuar vërrshime e dëme të konsiderueshme në shumë lokalitete të Istogut.

Duke filluar nga mëngjesi i ditës së sotme jemi në teren, me mjetet që kemi në dispozicion si komunë dhe bashkë me FSK-në, Zjarrëfikësit, Policinë, Hidrodrinin, Drinin e Bardhë, e firmat private të Istogut jemi duke bërë ndërhyrjet e nevojshme në lokalitetet ku kemi gjendje të rënduar të vërrshimeve.



Fotografia 96. Takim me Kryetarin e Komunës së Istogut



Dua të ju siguroj të gjithëve që ekipet tona emergjente do të jenë në teren në vazhdimësi për të ndërhyrë në zonat kritike dhe për të parandaluar e sanuar dëmet deri në uljen e të reshurave dhe normalizimit të situatës.

Me datë 20.01.2023 Kryetari i Komunës Ilir Ferati, sot ka thirrë në takim të përbashkët Shtabin Emergjent Komunal të përbërë nga drejtor të drejtorive, Komandantin e Policisë së Kosovës në Istog, FSK-në dhe Zjarrëfikësit. Në takim u diskutua për gjendjen e krijuar nga të reshurat e pandërprera të shiut dhe dëmet që janë shkaktuar në shumë fshatra dhe rrugë publike të territorit të Komunës së Istogut. Kryetari Ferati ka formuar 8 komisione për të bërë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në ekonomitë familjare, biznese dhe në bujqësi, poashtu bëri thirrje që të gjitha ekipet emergjente dhe drejtorët e drejtorive në komunën tonë të qëndrojnë aktiv gjatë gjithë kohës si dhe të jenë në shërbim të atyre që kanë nevojë, në mënyrë që të vlerësojmë saktë dëmet materiale të shkaktuara.

Me datë 23.01.2023 Kryetari i Komunës Ilir Ferati, sot mbajti mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve.

Në mbledhjen e mbajtur sot u diskutua për gjendjen aktuale të vërshimeve në Komunën e Istogut, me theks të veçantë për masat e ndërmarra nga komisionet e formuara për raportin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e fundit në vend.

Kryetari Ferati, kërkoi nga drejtoritë përkatëse, që deri të mërkurën të përfundoj raporti final sa i përket vlerësimit të dëmeve.

Në këtë mbledhje u konstatua se ka dëme të konsiderueshme materiale, ku janë dëmtuar objekte kolektive, shtëpi banimi, biznese, ferma bujqësore e infrastrukturë publike



Fotografia 97. Kryetarit i Komunës së Istogut në takim me zyrtar

Me datë 23.01.2023 Kryetari i Komunës së Istogut, Ilir Ferati, i shoqëruar me një pjesë të kabinetit, kanë pritur në takim Ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Faton Peci, me të cilin diskutuan për dëmet e shkaktuara nga vërshimet në bujqësi.

Kryetari Ferati tha se: “Ne kemi formuar komisionet të cilët po e bëjnë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut dhe po angazhohemi për të sanuar sa më parë ato dëme, në mënyrë që t’u dalim në ndihmë qytetarëve që kanë pësuar nga kjo fatkeqësi natyrore”.



Fotografia 98. Kryetari i Komunës së Istogut me Ministrin e Bujqësisë në takim

Ndërsa, Ministri Peci tha se: “Pas vlerësimit të dëmeve dhe raportet që do ti sjellin drejtoritë komunale, ne si Ministri do ti pranojmë këto kërkesa dhe në bazë të dëmeve do të shqyrtojmë kompensimin e tyre, poashtu urojë që kjo gjendje mos të përsëritet më kudo në Kosovë”. Në fund Kryetari Ferati, falënderoj Ministrin Peci për vizitën dhe i kërkoj përkrahje konkrete, masa dhe veprime për t’u dalë në ndihmë qytetarëve të komunës së Istogut.

Me datë 24.01.2023 Shoqata Bamiçëse “Jetimat e Ballkanit” dhuron 50 pako ushqimore dhe higjienike, komunës së Istogut.



Fotografia 99. Mobilizimi i Shoqatës Bamiçëse “Jetimat e Ballkanit

Komuna e Istogut ka pranuar donacion nga Shoqata Bamiçëse Jetimat e Ballkanit, 50 pako ushqimore dhe higjienike, si ndihmë familjeve të prekura nga vërshimet.

Pakot e dhuruara përmbajnë artikuj ushqimor dhe material higjienik.

Të pranishëm gjatë pranim dorëzimit të pakove ushqimore dhe higjienike ishin Drejtoresha për Mirëqenie Sociale, Merita Bytyçi-Muzliçaj, zyrtarë të Kryqit të Kuq dhe përfaqësuesi i Shoqatës “Jetimat e Ballkanit”.



Fotografia 100. Shpërndarja e ndihmave të banoirët e prekur nga vërshimet

Komuna e Istogut, më këtë rast falënderon përfaqësuesit e Shoqatës Bamirëse „Jetimat e Ballkanit“ për donacionin, që është një ndihmë e mirëseardhur për familjet prekura nga vërshimet.

25.01.2023-, Me Shefin e Grupit Parlamentar të LDK-së, z. Arben Gashi, dhe miqtë tanë Valentinën, Armendin, Rrezartën dhe Shkëmbin, vizituam nga afër zonat e prekura nga vërshimet në Istog.



Fotografia 101. Kryetarit i Komunës në takim me Grupin parlamentar të LDK-së

Dëmet materiale që u janë shkaktuar qytetarëve tanë janë të mëdhaja, andaj edhe ndihma nga Qeveria e Kosovës është shumë e nevojshme. U shpreha falënderimin e sinqertë deputetëve, për vizitën duke u kërkuar që të ngrisin zërin në Kuvendin e Kosovës për t’iu dalë në ndihmë komunave të prekura nga vërshimet.

Bashkë do e kalojmë këtë sfidë!



10.2.4. Komuna e Deçanit

Me datë 20.01.2023- meqenëse gjatë këtyre ditëve kemi pasur reshje të theksuara atmosferike, Kryetari i Komunës, z. Bashkim Ramosaj së bashku me Drejtorin për Mbrojtje Shpetim dhe Shërbime Publike, z. Izet Zenuni, bashkë me ekipin dhe njësitë kanë intervenuar me institucionet, si me Shtabin Emergjencat në Komunë, Njësitë e Zjarrfikësive, Kompanin Higjiena, Hidrodriini, dhe Kompanin Lika - Trade, kanë intervenuar në fshatin Baballoq, Carrabreg i Epërm, Lagjia e Deçanit, Sllup, Voksh, Pobergj, Irzniq, Strellc i Ulët dhe në rrugën Deçan - Plavë.



Fotografia 102. Pamje të dëmeve në Komunën e Deçanit

Ka pasur dëme të konsiderueshme në infrastrukturën rrugore, ekonomitë familjare dhe bizneset. Kërkojmë nga qytetarët për çdo ankesë të drejtohen tek ne.



Fotografia 103. Vërshimet në Komunën e Deçanit

22.01.2023. Ekipet operative të Ndërmarrjes Publike Lokale "Higjiena", sot, kanë vepruar në qytetin e Skenderajt, për të ju dalë në ndihmë me makineri dhe punëtor fizik qytetarëve të kësaj komune, e cila po kalon një situatë të vështirë nga vërshimet që kanë ndodhur së fundmi.



Fotografia 104. Puntorët duke pastruar mbetjet nga vërshimet në Komunën e Deçanit

Duke i falënderuar punëtorët e kompanisë "**Higjiëna**", uroj që të kalojmë këtë situatë sa më parë pa dëme të mëdha.



11 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

11.1. KONKLUZIONE

Pasojat nga ky rrezik janë kryesisht në ekonomi familjare, toka bujqësore dhe infrastrukturë. Dëmet janë të konsiderueshme.

Si përfundim, përveç faktorit natyror që kanë ndikuar në vërshim të ujërave kanë ndikuar dhe në vendet urbane dhe rurale të të gjitha llojeve, si:

- Ndërtimet e egra të objekteve të banimit në shtretërit dhe brigjet e lumit;
- Të reshurave intenzive të shiut (faktor natyror);
- Mos rregullimi i shtretërve të lumenjve sipas standardeve të kërkuara;
- Mirëmbajtja e pamjaftueshme e rrjetit të ujërave atmosferik, fekal, kanaleve të hapura të ujitjes, etj. që kalojnë edhe nëpër qytet, shtretërve të lumenjve, urave etj;
- Hedhja e mbeturinave të ndryshme në lumenjë, kanale dhe bllokimi i urave;
- Gërmimet dhe eksploatimi i pa kontrolluar i (inerteve) resurseve natyrore që ka shkaktuar ndërrimin e kahjes së rrjedhës së ujit, e pastaj edhe daljen nga shtrati;
- Mos mirëmbajtja e objekteve ekzistuese të lumenjëve nga organet kompetente;
- Shkatërrimi i pyjeve;
- Ngushtimi i shtretërve të lumenjve nga pronarët që i posedojnë prona pranë lumenjëve;
- Gjithashtu vërshimit i ka kontribuar edhe mbyllja e kanaleve anësore të rrugëve.
- Shumë shkaktarë tjerë që ndikojnë negativisht në rrjedhën e lumit.

11.2. REKOMANDIME

- Marrja e masave për rregullimin, mirëmbajtjen dhe pastrimin e shtretërve të lumenjëve;
- Ndalimi i shfrytëzimit të pakontrolluar i lëndëve inerte nga shtretërit e lumenjëve në Kosovë;
- Marrja e masave nga organet e nivelit lokal në menaxhimin adekuat të mbeturinave dhe pastrimi i shtretërve të lumenjëve brenda zonave urbane;
- Marrja e masave në mirëmbajtjen e rrjetit të ujërave atmosferike dhe fekale;
- Të ngritet niveli i bashkëpunimit ndërinstitucional, veçanërisht mes nivelit komunal, kompanive rajonale të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe Institucioneve të nivelit qendror, lidhur me parandalimin dhe mbrojtjen nga vërshimet; dhe
- Masa të tjera që ndikojnë pozitivisht për mbrojtjen nga ndikimet e veprimeve të dëmshme të ujërave.



BIBLIOGRAFIA - burimet e të dhënave

Faqet zyrtare të Kryeministrisë;
Faqet zyrtare të Ministrive të linjës;
Faqet zyrtare të AME-së
Faqet zyrtare të IHMK-së;
Faqet zyrtare të komunave të prekura nga vërshimet;
Portale, revista, gazeta nga rrjete sociale;

